



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 41/2021 Regjistri (JR)  
Datë 23.07.2021

Nr. 54 i vendimit  
Datë 19.12.2023

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi Gjykses i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Relatore</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Anëtar</b>

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 19.12.2023, ditën e martë, ora 10:55, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar z. Gerrit Sprenger, me sekretare gjyqësore Anisa Sejdini, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Kolë Hysenaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**OBJEKT:** Shqyrtimi i vendimit nr. 368, datë 19.04.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**BAZA LIGJORE:** Neni F i Aneksit të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë. Neni 63, pika 2 dhe neni 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Trupi gjykses i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, të paraqitura në ankim dhe në parashtrime, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 368, datë 19.04.2021, të Komisionit të Pavarur

të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

## VËREN:

### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Kolë Hysenaj (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) administroi raportet e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit, të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”).

2.1. ILDKPKI-ja<sup>1</sup>, pasi kreu procedurën e kontrollit të pasurisë, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, i dërgoi Komisionit aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë së subjektit të rivlerësimit Kolë Hysenaj, duke konkluduar se:

- i. deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- ii. nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii. ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv. ka kryer deklarim të rremë;
- v. subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2. DSIK-ja<sup>2</sup> vuri në dispozicion të Komisionit raportin për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Kolë N. Hysenaj, fillimisht me konstatimin për përshtatshmërinë në vazhdimin e detyrës. Pas kërkesës së Komisionit për deklasifikimin e raportit dhe përditësimin e të dhënave, DSIK-ja<sup>3</sup> vuri në dispozicion raportin mbi kontrollin e figurës të deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 27.12.2019, të Komisionit të Deklasifikimit dhe të Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror” (në vijim “KDZh”), nga ku rezultoi se për këtë subjekt ka pasur informacion nga institucionet e verifikimit, bazuar në të cilat Grupi i Punës ndryshoi konstatimin fillestar nga përshtatshmëri në vijimin e detyrës, në papërshtatshmëri për vijimin e detyrës.

2.3. KLP-ja<sup>4</sup> i dërgoi Komisionit raportin e vlerësimit profesional. Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e formularit të vetëdeklarimit tre grupeve të burimeve të

---

<sup>1</sup>Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 31.10.2018, “Dërgohet akti i përfundimit të kontrollit të plotë, të pasurisë së subjektit Kolë Hysenaj, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

<sup>2</sup>Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 02.11.2017, e DSIK-së, ndodhur në dosjen e Komisionit.

<sup>3</sup>Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 31.12.2019, e DSIK-së, ku përcillet raporti nr. {\*\*\*} prot., datë 19.12.2019, mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Kolë Hysenaj.

<sup>4</sup>Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 24.04.2020, protokolluar nga Komisioni me nr. {\*\*\*} prot., datë 18.05.2020.

informacionit: (a) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; (b) pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short dhe të dhënave nga burimet arkivore në Sektorin e Burimeve Njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme. Subjekti është vlerësuar përgjithësisht pozitivisht në drejtim të aftësive profesionale, organizative, etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale.

## **II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

3. Komisioni, për subjektin e rivlerësimit, ka zhvilluar procesin e hetimit administrativ për të tria kriteret e vlerësimit, përkatësisht për kontrollin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Komisioni përfundoi procesin e rivlerësimit duke arritur në konkluzion vetëm për kriterin e pasurisë.

3.1. Komisioni, bazuar në provat e administruara gjatë procesit të rivlerësimit, si dhe në qëndrimin e subjektit të rivlerësimit për çdo çështje, rast pas rasti, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Kolë Hysenaj nuk arrin nivelin kualifikues, për sa i takon kriterit të pasurisë, pasi ka kryer deklarime të pasakta dhe të pamjaftueshme, sipas nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016 dhe me vendimin nr. 368, datë 19.04.2021, vendosi *shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Kolë Hysenaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

## **III. Shkaqet e ankimit**

4. Kundër vendimit nr. 368, datë 19.04.2021, të Komisionit, ka ushtruar ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”) subjekti i rivlerësimit, në zbatim të nenit 63, pika 2, nenit 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, duke kërkuar nga Kolegji:

4.1 *Prishjen e këtij vendimi, duke urdhëruar Komisionin të vazhdojë të kryejë procesin e rivlerësimit, edhe për kriteret e kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, për të cilat nuk arsyetohet në vendim nga Komisioni.*

*ose në alternativë*

4.2. *Kalimin në seancë gjyqësore publike të çështjes administrative me nr. 368 vendimi, datë 19.04.2021, të Komisionit, ndryshimin e vendimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, prokurorit Kolë Hysenaj.*

4.3. Në parashtrimet e depozituara në Kolegji më datë 11.12.2023, subjekti i rivlerësimit kërkoi ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe konfirmimin e tij në detyrë.

5. **Shkaqe të ankimit lidhur me procesin e rregullt ligjor**

5.1. Vendimi i Komisionit është rezultat i një procesi të paragjykuar, pasi gjatë gjithë procesit u hetua nga e njëjta trupë gjykuese që mori dhe vendimin, si rrjedhojë nuk është gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.

5.2. Gjatë procesit të tij është shkëlur neni 6/1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ( në vijim “KEDNJ”), pasi nuk është gjykuar nga një gjykatë e krijuar me ligj, pasi anëtarët e Komisionit nuk janë gjyqtarë.

5.3. Është cenuar e drejta e parashikuar nga neni 8 i KEDNJ-së, për shkak se masa e dhënë nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

5.4. Mosarsyetime në vendimin e Komisionit për dy kriteret e rivlerësimit atë të figurës dhe të aftësive profesionale, duke mos arritur në konkluzion lidhur me këto dy kriteret, e bën vendimin të pavlefshëm dhe përbën shkak për prishjen e tij dhe kthimin e çështjes për rigjykim<sup>5</sup>.

5.5. Komisioni ka arritur në një konkluzion të gabuar, pasi deklarimi mund të konsiderohet i pasaktë, sipas nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016, vetëm kur nga hetimi rezultojnë prova, sipas së cilave subjekti ka kryer (me veprime ose mosveprime) fshehje ose falsitet dhe nëse kalohet testi i dyfishit të pasurisë.

## 6. Shkaqe të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

6.1. Për pasurinë “tokë arë” me sipërfaqe 2000 m<sup>2</sup> të ndodhur në {\*\*\*}, Tiranë, subjekti i rivlerësimit pretendon se nëse merren në konsideratë kursimet që ka krijuar përgjatë viteve 2003-2010, të siguruara nga pagat, aktiviteti bar-kafe dhe diferenca e shitblerjeve të pasurive, ai do të rezultonte me një balancë pozitive në vlerën prej 8.023.170 lekësh.

6.2. Për pasurinë automjetet tip “Peugeot” me targa {\*\*\*} dhe automjetin tjetër me targa {\*\*\*}, të ardhurat e të cilit kanë shërbyer si burim për krijimin e automjetit tip “Peugeot”, subjekti i rivlerësimit pretendon se nëse merren në konsideratë të ardhurat e ligjshme të siguruara nga shitja e pasurisë së paluajtshme të ndodhur në {\*\*\*}, Petrelë, ai do të rezultonte me mjaftueshmëri burimesh financiare për blerjen e automjeteve.

6.3. Lidhur me mungesën e burimeve financiare për krijimin e pasurisë automjetet me targa {\*\*\*}, blerë në vitin 2015, i cili është shkëmbyer më pas me automjetin me targa {\*\*\*} të deklaruar në deklaratën *vetting*, subjekti pretendon se Komisioni, në interpretim të gabuar të ligjit dhe akteve shkresore të administruara, nuk ka marrë në konsideratë të ardhurat nga shitja e një automjeti tjetër në vitin 2010, për shkak të mospagimit të detyrimit tatimor në kohë reale dhe mosdeklarimit të kursimeve në fund të vitit 2010.

6.4. Për pasurinë e paluajtshme të llojit truall me sipërfaqe 316 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë me sipërfaqe 50,90 m<sup>2</sup>, ndodhur në Korçë, subjekti pretendon se si burim krijimi ka shërbyer depozita bankare në shumën 128.000 euro, e cila është krijuar nga kursimet e periudhës 2011-2015 (pjesa kryesore nga të ardhurat e shitjes së pasurisë ndodhur në {\*\*\*}, Tiranë). Sipas subjektit, për sa kohë vërtetohet mundësia e krijimit të shumës prej 128.000 eurosh dhe ligjshmëria e saj, pavarësisht se këto kursime nuk i ka deklaruar në deklaratat e interesave periodike të kohës, ato duhen të përfshihen në analizën financiare.

6.5. Lidhur me depozitim të shumës prej 20.000 eurosh në “Tirana Bank”, subjekti i rivlerësimit pretendon se nëse analizohen të ardhurat nga biznesi për vitin 2007-2009 apo dhe nëse do të

---

<sup>5</sup>Subjekti i rivlerësimit referon në vendimin nr. 14, datë 15.06.2021, të Kolegjit, që i përket (SR) I. B..

verifikohet mundësia për të kursyer për periudhën 2003-2010, ai do të mund të justifikonte krijimin e depozitës në shumën prej 20.000 eurosh me të ardhura të ligjshme.

**6.6.** Lidhur me analizën financiare për vitin 2003-2016, subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji të merren në konsideratë arsyetimet dhe dokumentacioni i paraqitur prej tij, për të cilin pretendon se nuk është vlerësuar dhe referuar nga ana e Komisionit, konkretisht si më poshtë.

**6.6/a.** Reduktimin e shpenzimeve të udhëtimit të tij dhe familjarëve jashtë vendit, pasi akomodimi është mbuluar kryesisht nga të afërmit e tij.

**6.6/b.** Të mos llogaritet si detyrim shuma e dhënë hua nga vëllai i tij, pasi kjo hua është falur prej tij.

**6.6/c.** Të rillogariten të ardhurat nga biznesi bar-kafe.

**6.6/ç.** Të reflektohen në analizë të ardhurat nga dietat, të cilat i ka përfituar për shkak të ushtrimit të funksionit larg vendbanimit.

**6.6/d** Të reduktohet kosto e ndërtesës së banesës njëkatëshe me sipërfaqe 71 m<sup>2</sup>, sipas vlerës së përcaktuar në aktin e kolaudimit dhe kjo vlerë të shpërndahet përgjatë viteve 2008-2009, në masën ¾ e kostos në vitin 2008 dhe ¼ e kostos në vitin 2009.

**6.6/e.** Të reflektohet në analizë e ardhura nga shitja e automjetit “Mercedes-Benz” dhe automjetit “Peugeot”, pasi është paguar detyrimi tatimor për diferencën e rezultuar nga çmimi i shitjes në raport me blerjen për këto automjete.

**6.6/f.** Të mos llogaritet si shpenzim e gjithë shuma prej 20.000 eurosh, pasi një pjesë ka mbetur kursim në vitin 2011 dhe ka shërbyer si burim për të krijuar pasurinë e ndodhur në {\*\*\*}, Tiranë.

**6.6/g.** Të merren në konsideratë kursimet e realizuara për periudhën 2011-2016, të cilat kanë shërbyer për krijimin e depozitës prej 128.000 eurosh, e cila më pas ka shërbyer si burim për krijimin e dy pasurive të paluajtshme në Korçë.

## **7. Shkaqet e ankimit për kriterin e kontrollit të figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale**

**7.1.** Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se raporti i dytë i përgatitur nga DSIK-ja, i cili ndryshon konstatimin fillestar nga përshtatshmëri në vijimin e detyrës në papërshtatshmëri për vijimin e detyrës, është plotësisht i pabazë dhe i ngritur mbi fakte që nuk ekzistojnë.

**7.2.** Sipas subjektit, të gjitha konstatimet e vendosura në themel të raportit të DSIK-së bazohen tërësisht në pretendime dashakeqëse të dërguara në formë anonime nga një person me qëllimin e vetëm të dëmtimit të imazhit të tij. Grupi i punës së DSIK-së nuk iu është përmbajtur detyrave ligjore që normojnë punën e tyre, pasi nga vlerësimi i të gjitha rrethanave nuk u konstatua asnjë indicie apo rrethanë që të mbështesë konkluzionin e tyre joobjektiv.

**7.3.** Lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji, që bazuar në raportin e grupit të punës mbi aktet dhe praktikatat e trajtuara prej tij ndër vite, në konsideratë të konstatimeve të Komisionit (pavarësisht se nuk është shprehur me konstatim përfundimtar në vendim) dhe shpjegimeve të dhëna prej tij gjatë këtij procesi, të vlerësohet *i aftë*, pasi, sipas tij, është provuar se ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, është treguar eficient dhe efektiv në një masë të pranueshme, në përputhje me nenin 44, pika “a” e ligjit nr. 84/2016.

#### IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

##### A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

###### a) Juridiksioni i Kolegjit

8. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit Kolë Hysenaj, duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

###### b) Legjitimimi i ankuesit

9. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh<sup>6</sup> nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

###### c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

10. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012, i ndryshuar”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve.
11. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike me praninë e subjektit të rivlerësimit, kontrollon zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, si dhe vlerësoi dokumentacionin e fashikullit të administruar gjatë hetimit në Komision, bazuar edhe në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, nuk konstatoi shkelje procedurale, të tilla që të kërkojnë korrigjimin e tyre, sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, duke kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve. Në referencë të dispozitës së sipërcituar, trupi gjykues çmoi, gjithashtu, se debati

---

<sup>6</sup>Sic rezultoi nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 368, datë 19.04.2021, për rivlerësimin e subjektit Kolë Hysenaj, i është njoftuar subjektit të rivlerësimit me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 14.06.2021, konfirmuar marrja dijeni nga subjekti i rivlerësimit më datë 15.06.2021, sipas lajmërimarrjes së shërbimit postar. Kurse ankimi i subjektit rezultoi të jetë depozituar në Komision në datën 29.06.2021, konfirmuar sipas të dhënave të vulës së protokollit të Komisionit, nr. {\*\*\*}, datë 29.06.2021, që rezultoi të jetë dita e 14-të nga data e marrjes dijeni për vendimin e Komisionit, sipas njoftimit të këtij të fundit. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit Kolë Hysenaj e ka dorëzuar ankimin e tij në Komision brenda afatit ligjor për të ushtruar ankim, në përputhje me nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016

gjqësor në seancë gjyqësore me praninë e subjektit të rivlerësimit nuk është i nevojshëm dhe se lidhur me këtë çështje mund të arrihej në vendimmarrje nga shqyrtimi mbi bazën e dokumenteve të administruara në fashikullin e Komisionit.

12. Me parashtrimet para seancës<sup>7</sup>, subjekti i rivlerësimit paraqiti disa akte<sup>8</sup> në cilësinë e provave të reja, për të cilat trupi gjykues vlerësoi se nuk plotësojnë kërkesat e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, duke refuzuar marrjen e tyre, bazuar në nenin 49, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016<sup>9</sup>.

Në përfundim, trupi gjykues vendosi të vijojë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

## **B. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit për procesin e rregullt ligjor**

13. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se *vendimi i Komisionit është rezultat i një procesi të paragjykuar, pasi gjatë gjithë procesit u hetua nga e njëjta trupë gjyqësore që mori dhe vendimin, si rrjedhojë nuk është gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme*, trupi gjykues

---

<sup>7</sup>Më datë 11.12.2023, pas njoftimit të marrë për caktimin e datës së gjykimit të çështjes në dhomë këshillimi, subjekti i rivlerësimit dorëzoi pranë Kolegjit “Parashtrime për gjykimin e çështjes së juridiksionit të rivlerësimit nr. 41/2021, datë 23.07.2021, kundër vendimit nr. 368, datë 19.04.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”.

<sup>8</sup>Subjekti kërkoi të administrohen dhe vlerësohen aktet shkresore si më poshtë:

- shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 04.02.2022, lëshuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë;
- vendim nr. {\*\*\*} prot., datë 04.02.2022, “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasi V. B.” i ILD-së;
- shkresa nr. {\*\*\*} pro.t, datë 05.06.2023, lëshuar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës;
- vendimi nr. {\*\*\*}, datë 14.09.2021, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës;
- vendimi nr. {\*\*\*}, datë 14.06.2021, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë;
- shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 11.07.2023, e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm;
- shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 01.08.2023, e Drejtorisë së Administrimit Gjyqësor, pranë Gjykatës së Lartë;
- vendimi nr. {\*\*\*}, datë 24.03.2023, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë;
- shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 21.07.2023, e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës;
- vendimi nr. {\*\*\*}, datë 09.04.2021, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës;
- shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 09.06.2023, nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm;
- shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 05.04.2023, nga Gjykata e Lartë;
- vendimi nr. {\*\*\*}, datë 07.07.2022, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë;
- kërkesë për informacion & shkurtim vendimi nr. {\*\*\*} Regj Them, datë 30.10.2023, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm;
- kërkesë për kopje aktesh & kthim përgjigje nr. {\*\*\*} prot., datë 29.03.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë (përfshirë aktet procedurale pjesë të procedimit penal nr. {\*\*\*});
- shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 18.04.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë;
- shkresa kthim përgjigje nr. {\*\*\*} prot., datë 18.04.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë (së bashku me kopjet e vendimeve të Drejtuesit të Prokurorisë për shfuqizimin e vendimeve);
- kërkesë për informacion & kthim përgjigje nr. {\*\*\*} prot., datë 29.03.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë (përfshirë aktet procedurale në kuadër të procedimit penal nr. {\*\*\*});
- kërkesë për informacion & kthim përgjigje nr. {\*\*\*} prot., datë 03.04.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë (përfshirë aktet procedurale në kuadër të vendimeve penale nr. {\*\*\*} dhe {\*\*\*} të vitit 2015).

<sup>9</sup>Neni 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, parashikon se: “Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: (a) marrja e provës duket se është e panevojshme; (b) fakti që kërkohet të provohet, është i parëndësishëm për vendimmarrjen ose mund të rezultojë i provuar gjatë gjykimit [...]”.

konstaton se ky pretendim i subjektit nuk është ngritur gjatë zhvillimit të procesit të rivlerësimit në Komision, por ngrihet për herë të parë në ankimin e paraqitur në Kolegjin.

Referuar jurisprudencës së Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut (në vijim “GjEDNJ”), ndër të tjera, në *Morel kundër Francës*, *Hauschildt kundër Danimarkës* etj., në kuptimin e nenit 6, paragrafi 1 i KEDNJ-së, njohja e thelluar e dosjes nga gjyqtari nuk nënkupton një paragjykim që e pengon të konsiderohet si i paanshëm në momentin e gjykimit në themel dhe vlerësimi paraprak i të dhënave nuk mund të çojë në paragjykimin e vlerësimit përfundimtar.

Në çështjen gjyqësore *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, për pretendime të njëjta të kërkuases me sa më sipër<sup>10</sup>, GjEDNJ-ja ka vlerësuar se nuk ka shkelje të nenit 6, pika 1 e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim “KEDNJ”), në drejtim të parimit të gjykatës së paanshme<sup>11</sup>.

Trupi gjykues i Kolegjit vëren se kompetenca e Komisionit për të kryer hetimin dhe për të dhënë vendimin është në përputhje me natyrën e procesit kalimtar, si një proces administrativ i nisur kryesisht, në përputhje me kompetencën që i njeh Kushtetuta dhe kreu VII “Procedura e rivlerësimit”, i ligjit nr. 84/2016, në të cilin detajohen kompetencat hetimore dhe vendimmarrëse të Komisionit, konfirmuar ky qëndrim edhe në jurisprudencën tashmë të konsoliduar të Kolegjit. Sa më sipër, pretendimi i ngritur nga subjekti i rivlerësimit është i pabazuar.

14. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se *gjatë procesit të tij të rivlerësimit është shkelur neni 6/1 i KEDNJ-së, pasi nuk është gjykuar nga një gjykatë e krijuar me ligj, anëtarët e Komisionit nuk janë gjyqtarë*, trupi gjykues i Kolegjit vëren se ky pretendim lidhet me organizimin dhe funksionimin e institucioneve që realizojnë procesin e rivlerësimit, sipas parashikimeve kushtetuese dhe ligjore dhe jo me veprime apo mosveprime konkrete të Komisionit që lidhen me rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit individualisht. Përputhshmëria e veprimtarisë së institucioneve që kryejnë procesin e rivlerësimit me parimet e nenit 6 të KEDNJ-së, në drejtim të garantimit të pavarësisë dhe paanshësisë, është certifikuar në fillim të procesit nga Komisioni i Venecias, ka kaluar testin e kushtetutshmërisë nga Gjykata Kushtetuese, si dhe çështja e gjykatës së krijuar me ligj është konfirmuar nga shqyrtimi në praktikë nga GjEDNJ-ja në vendimin që i përket *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*<sup>12</sup>, në konkluzionin se institucionet e krijuara për të kryer rivlerësimin përbushin garancitë e sanksionuara nga neni 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), për sa i përket gjykatës së krijuar me ligj. Në të njëjtën mënyrë ka konkluduar edhe Kolegji në jurisprudencën e deritanishme<sup>13</sup> në analizën e pretendimeve të ngjashme nga subjekte të tjera rivlerësimi. Nën dritën e gjithë këtyre arsyetimeve, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se procesi i rivlerësimit të tij nuk është kryer nga një gjykatë e krijuar me ligj, për shkak të faktit që komisionerët nuk vijnë nga radhët e gjyqësorit, është i pabazuar.
15. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas së cilit *Komisioni ka cenuar nenin 8 të KEDNJ-së, pasi në rastin objekt gjykimi, masa e dhënë për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit*, trupi gjykues vlerëson se analiza, lidhur me respektimin ose jo të parimit të proporcionalitetit në dhënien e masës së shkarkimit të subjektit nga detyra, është objekt kontrolli nga ana e Kolegjit në shqyrtimin e shkaqeve të ankimit që kundërshtojnë konkluzionet e Komisionit lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë, të cilat kanë çuar në marrjen e vendimit për shkarkimin e subjektit.

<sup>10</sup>Paragrafi 230 i vendimit të GjEDNJ-së *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*.

<sup>11</sup>Paragrafët 307, 308 dhe 317 të të njëjtit vendim të GjEDNJ-së.

<sup>12</sup>Paragrafët 280 - 288 të vendimit të GjEDNJ-së, *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*.

<sup>13</sup>Vendimi nr. 19/2022 (JR), i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, paragrafi 20.



15.1. Trupi gjykues konstatoi se në çështjen konkrete, Komisioni, në ushtrim të kompetencave të tij për vlerësimin e provave dhe rëndësinë e tyre provuese, ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit për kriterin e pasurisë ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të parashikuara në nenin 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016, të cilat janë shkaqe që çojnë në dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, bazuar në parashikimet e nenit 61, pika 3 e këtij ligji. Trupi gjykues do të arsyetojë dhe konkludojë lidhur me këtë shkak ankimi, në vijim, nëse gjen vend aplikimi i parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, i pretenduar nga subjekti i rivlerësimit.

Pavarësisht sa më sipër, ky pretendim i subjektit gjendet i pabazuar në ligj, mbështetur në faktin që dispozitat e ligjit nr. 84/2016 i janë nënshtruar edhe procesit të kontrollit të kushtetutshmërisë, vlerësuar sipas vendimit nr. 2, datë 18.01.2017, të Gjykatës Kushtetuese. Gjithashtu, rezultoi se edhe GjEDNj-ja në vendimin e saj në çështjen *Xhoxhaj<sup>14</sup> kundër Shqipërisë*, në shqyrtimin e pretendimeve të kërkuases, të ngjashme me këto të subjektit të rivlerësimit, ka vlerësuar se nuk ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës në lidhje me masën e shkarkimit nga detyra të kërkuases.

16. Subjekti i rivlerësimit pretendon se *Komisioni në vendimin e tij nuk ka arsyetuar në lidhje me dy kriteret e rivlerësimit atë të figurës dhe të aftësive profesionale, si dhe duke mos arritur në konkluzion lidhur me këto dy kritere, ka vepruar në kundërshtim me Aneksin e Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, duke e bërë vendimin e Komisionit të pavlefshëm, çka përbën shkak për prishjen e tij dhe kthimin e çështjes për rigjykim<sup>15</sup>* dhe kërkon nga Kolegji që të urdhërojë Komisionin të vazhdojë të kryejë procesin e rivlerësimit, edhe për kriteret e kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, për të cilat nuk arsyetohet në vendim nga Komisioni.

16.1. Në funksion të këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues analizoi procedurën e ndjekur nga Komisioni, nga ku rezultoi se:

Me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 13.07.2020, Komisioni vendosi mbylljen e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit Kolë Hysenaj, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit, sipas parashikimit të pikës 1, të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016. Në datën 31.08.2020, subjekti i rivlerësimit paraqiti, përmes postës elektronike, parashtrimet dhe provat mbi rezultatet e hetimit, jo vetëm për kriterin e pasurisë, por edhe për kriterin e kontrollit të figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Sa i takon këtyre kritereve, konstatohet se Komisioni në vendim vetëm i ka përmendur faktet e evidentuara nga organet ndihmëse që kanë kryer vlerësimin, sipas ligjit, si dhe hapat hetimore të

---

<sup>14</sup>GjEDNj-ja është shprehur: [...] Në të vërtetë, ligji nr. 84/2016 parashikon dy lloje sanksionesh disiplinore: shkarkimin nga detyra ose pezullim me detyrimin për të ndjekur trajnimin e detyrueshëm. Gjykata ka konsideruar, ndër të tjera, se mungesa e një shkalle të përshtatshme sanksionesh për shkelje disiplinore mund të jetë në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit (shih Oleksandr Volkov, paragrafi 182). Në lidhje me këtë, gjykata duhet të theksojë se ligji për Gjykatën Kushtetuese parashikon një hierarki më të hollësishme sanksionesh disiplinore, siç përshkruhet në paragrafin 200 më lart, i cili vendoset në përfundim të procesit të zakonshëm disiplinor. Sidoqoftë, procesi i rivlerësimit ka natyrë sui generis, me gjithë ngjashmëritë që duket se ka me proceset e zakonshme disiplinore. Ai është miratuar në përgjigje të pranisë së perceptuar të përhapur të korrupsionit në sistemin e drejtësisë, në mënyrë që të largojë elementet e korruptuara dhe të ruajë pjesën e shëndetshme të sistemit. Në rrethanat e jashtëzakonshme që i paraprijnë miratimit të ligjit nr. 84/2016, siç theksohet, gjithashtu, në paragrafët 391, 392 dhe 404 më lart, gjykata konstaton se është në përputhje me frymën e procesit të rivlerësimit që të ketë një shkallë më të kufizuar sanksionesh, në rast se një person nuk arrin të përmbushë një nga tri kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 84/2016. [...].

<sup>15</sup> Subjekti i rivlerësimit referon në vendimin e Kolegjit nr. 14, datë 15.06.2021, që i përket (SR) I. B..

ndërmarrja nga Komisioni, por pa arritur në ndonjë konkluzion apo vendimmarrje për sa ka hetuar gjatë hetimit administrativ. Komisioni, megjithëse ka arsyetuar lidhur me çështjet që kanë rezultuar për këto dy kritere, nuk ka konkluduar me një qëndrim për rivlerësimin e subjektit në dy kriteret e tjera, për kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

Sikurse vërehet, Komisioni ka kryer një hetim të thelluar për kriterin e kontrollit të figurës dhe kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, i ka kaluar barrë prove subjektit për gjetjet e evidentuara gjatë hetimit administrativ për këto kritere, për të cilat subjekti ka paraqitur dokumentacion dhe ka dhënë shpjegime të detajuara në përgjigje të rezultateve të hetimit.

**16.2.** Në vendimin për subjektin e rivlerësimit, Komisioni ka nënvizuar se [...] gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes, vlerësoi që të gjitha konstatimet e bazuara në prova dhe në ligj janë të mjaftueshme për një vendimmarrje në favor të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bazuar vetëm në kriterin e pasurisë dhe në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, sipas pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016. Në këto rrethana, Komisioni<sup>16</sup> vlerësoi të mos analizojë gjetjet e tjera në lidhje me kriterin e vlerësimit të figurës dhe atë të aftësive profesionale, për sa kohë që, ndonjë përfundim mbi këto kritere nuk mund të ndryshojë vlerësimin përfundimtar bazuar në rivlerësimin e kriterit pasuror [...].

**16.3.** Në analizë të këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren se nenet D, Dh dhe E të Aneksit të Kushtetutës qartësisht zbërthejnë procesin e rivlerësimit në kritere të cilat edhe veçmas mund të sjellin si pasojë shkarkimin e subjekteve të rivlerësimit. Më tej, në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, ligjvënësi ka përcaktuar se është në interesin publik shqyrtimi i çështjes brenda një afati sa më të shpejtë të mundshëm dhe, për këtë arsye, ka parashikuar përfundimin bazuar vetëm në një kriter, kur rezultatet e hetimit për kriterin përkatës janë të mjaftueshme për të mbështetur vendimmarrjen.

Në referim të nenit 179/b, pika 1 e Kushtetutës, që parashikon se: “Sistemi i rivlerësimit ngrihet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si edhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi”, interpretuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit<sup>17</sup>, rezulton që procesi i rivlerësimit nuk ka për qëllim të verifikojë detyrimisht të tria kriteret e vlerësimit për subjektet e rivlerësimit, si një proces që përcakton standardin e tyre në përmbushje të detyrës apo gradën e vlerësimit të tyre. Kushtetuta dhe ligji kërkojnë që ky proces të zhvillohet në funksion të rikthimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë dhe të garantimit të funksionimit të shtetit të së drejtës. Në këtë kontekst të qëllimit të Kushtetutës, nuk do të merrte vlerë konstatimi i Komisionit për rivlerësimin e kriterëve të tjera,

---

<sup>16</sup>Në këtë vlerësim, Komisioni iu referua edhe qëndrimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, mbajtur për subjektin A. M., në paragrafin 69 të të cilit është shprehur se: “Në vijim të përfundimeve të arritura nga shqyrtimi i shkaqeve të mësipërme të ankimit të Komisionerit Publik, trupi gjykues çmon se konkluzionet lidhur me kontrollin e pasurive të deklaruara në deklaratën e pasurisë Vetting janë të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin përfundimtar lidhur me kriterin e kontrollit të pasurisë dhe vlerësimin se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të dhe, si pasojë, ndaj tij duhet të vendoset masa disiplinore e shkarkimit nga detyra” dhe në paragrafin 70 është shprehur se: “Në këto kushte, trupi gjykues e çmoi të panevojshëm analizimin e shkaqeve të tjera të ankimit dhe denoncimeve të publikut të paraqitura në Kolegj për subjektin e rivlerësimit, për sa kohë çdo konkluzion lidhur me to nuk do të arrinte të ndryshonte vlerësimin përfundimtar të trupit gjykues lidhur me këtë kriter të rivlerësimit dhe vendosjes së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra”. Të njëjtin qëndrim, Kolegji ka mbajtur edhe në vendimin nr. 27 datë 22.10.2020, për subjektin D. P., paragrafi 22.

<sup>17</sup>Vendimi nr. 6/2018(JR), i Kolegjit, që i përket subjektit B. N., vendimi nr. 1/2019(JR) që i përket subjektit A. L. dhe vendimi nr. 15/2019 (JR) që i përket subjektit D. Rr..

për sa kohë arrihet në konkluzionin se në verifikim edhe të një kriteri të vetëm, subjekti i rivlerësimi do të duhet të largohet nga sistemi i drejtësisë, me qëllim rikthimin e besimit të publikut te drejtësia.

Nga ana tjetër, neni 59 i ligjit nr. 84/2016, në pikën 1 parashikon se për konfirmimin në detyrë duhet që subjekti të rezultojë se përmbush të tria kriteret dhe, si i tillë, arrin të ketë në mënyrë kumulative nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

Ky fakt nuk e ndalon Komisionin që në rastet kur rezulton se nga hetimet e kryera, për një apo dy kriteret, një subjekt nuk arrin nivel të besueshëm të mund të përfundojë rivlerësimin duke e bazuar atë vetëm në një kriter.

**16.4.** Trupi gjykues vëren se Komisioni ka konkluduar në vendim se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm dhe ka vendosur masën e shkarkimit nga detyra, bazuar në nenin 61, pika 3, për deklaram të pamjaftueshëm në kriterin e pasurisë, i parë i ndërlidhur me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni e ka bazuar vendimmarrjen e tij për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, vetëm në kriterin e pasurisë dhe në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, sipas pikës 2, të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016<sup>18</sup>. Nga sa më lart, në rast se Komisioni do ta kishte bazuar vendimmarrjen e tij në përcaktimet e tjera të nenit 61 (61/2 apo 61/4), kjo do të sillte, për rrjedhojë edhe detyrimin e tij për arsyetimin e këtyre konkluzioneve në vendimin objekt shqyrtimi.

Në analizë të dispozitave ligjore të zbatueshme dhe dokumentacionit në fashikull, trupi gjykues arrin në përfundimin se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për pavlefshmëri të vendimit të Komisionit është i pabazuar, pasi nuk rezulton asnjë nga rastet e parashikuara nga neni 108 i Kodit të Procedurave Administrative.

17. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit, *Komisioni ka arritur në një konkluzion të gabuar, pasi deklarimi mund të konsiderohet i pasaktë, sipas nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016, vetëm kur nga hetimi rezultojnë prova, sipas të cilave subjekti ka kryer (me veprime ose mosveprime) fshehje ose falsitet dhe nëse kalohet testi i dyfishit të pasurisë*, trupi gjykues çmon se ky shkak ankimi ka të bëjë me interpretimin e konceptit të deklarimit të pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3, vlerësuar në raport me konstatimet e procedurës së vlerësimit të pasurisë, sipas nenit 33, pika 5 e të njëjtit ligj. Jurisprudenca e deritanishme e Kolegjit u ka dhënë përgjigje pretendimeve të tilla të subjekteve të rivlerësimit si të pabazuara në ligj, për sa kohë konstatimet e nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si situata të cilat mund ta vendosin subjektin e rivlerësimit në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, nuk vlerësohen në raport me njëra-tjetrën, por shihen si situata të pavarura, vlerësimi i të cilave në kuadër të prodhimit të pasojave të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 u nënshtrohet parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit. Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në konkluzionin se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar në ligj dhe nuk mund të përbëjë shkak për cenimin e vlefshmërisë së vendimit të Komisionit në drejtim të sa më sipër.

---

<sup>18</sup>Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve ose në vlerësimin tërësor të procedurave.

## C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

### 18. Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit për gjendjen *cash*

Trupi gjykues vëren se një pjesë e konsideruar e shkaqeve të ankimit për pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të krijuara prej tij afektohen nga gjendja e likuiditeteve *cash* të mbartur ndër vite, për këtë qëllim çmoi të japë një vlerësim mbi pretendimet e subjektit të rivlerësimit për gjendjen e *cash*-it.

18.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se, megjithëse nuk ka deklaruar gjendjen *cash* në fund të çdo viti, por ka deklaruar kursimet si burim të krijimit për pasuritë dhe analiza financiare e mundëson krijimin e tyre, Komisioni në mënyrë të padrejtë nuk i ka llogaritur kursimet e tij ndër vite. Mosdeklarimin e gjendjes *cash* përgjatë viteve 2003-2015, subjekti e konsideron pakujdesi në konceptimin që i ka bërë formularit të deklaratës së pasurisë, nuk ka pasur asnjë anë subjektive, por vetëm një lapsus, pasi ka menduar se mosdeklarimi i kursimeve në fund të çdo viti është deduksion, diferencë e të ardhurave në raport me pasurinë e krijuar dhe përballimin e shpenzimeve të tjera për jetesë.

Subjekti pretendon se Komisioni ka shkelur parimin e proporcionalitetit dhe ligjshmërisë duke paragjykuar çështjen, pasi, nëse analiza financiare mbi kursimet do të kryhet mbi mundësinë e subjektit për të krijuar kursimet, së paku në masën që ato kanë shërbyer për të likuiduar çmimin e pasurive të krijuara, ai do të rezultonte me mundësi financiare të ligjshme për krijimin e tyre.

18.2. Komisioni, në përfundim të vlerësimit përfundimtar, duke iu referuar deklarimeve të subjektit lidhur me shumën prej 135.000 USD përfituar në vitin 2013 nga shitja e pasurisë ndodhur në {\*\*\*}, Tiranë, të cilën pretendon që ta ketë përdorur si burim për blerjen e dy pasurive në Korçë në vitin 2016, si dhe deklarimeve për shumën prej 22.000 eurosh përfituar nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targë {\*\*\*}, në vitin 2010, pretenduar si burim për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targë {\*\*\*}, në vitin 2015, ka vendosur që kursimet e pretenduara *cash*, por të pavërtetuara, për më tepër të deklaruara në vlera të ndryshme në deklarime të ndryshme të subjektit, mos t’i marrë në konsideratë si të ardhura të ligjshme në analizën financiare përfundimtare.

18.3. Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues, pasi analizoi deklaratat e subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike ndër vite konstatoi se, duke filluar nga deklarimi fillestar dhe deri në vitin 2015, kur ka dhënë shpjegimet në ILDKPKI, subjekti nuk ka deklaruar ekzistencën e ndonjë sasive *cash*-i apo pakësimi të gjendjes së likuiditeteve.

Ligji nr. 9049/2003<sup>19</sup>, pavarësisht nga ndryshimet ndër vite, ka pasur detyrim të qartë për subjektet deklarues, përfshirë subjektin e rivlerësimit, për të pasqyruar çdo ndryshim të gjendjes *cash* në deklaratat periodike në gjendjen që ishin në 31 dhjetor të vitit të mëparshëm. Formulari

---

<sup>19</sup>Neni 4 parashikon: “Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë [...] gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: [...] (d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në *cash*, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj [...]”.

i deklarimit<sup>20</sup> të pasurisë për vitin 2004, i plotësuar nga subjekti i rivlerësimit, në faqen 3, ka përshkruar mënyrën se si duhen deklaruar interesat, duke udhëzuar zyrtarët të deklarojnë çdo ndryshim (shtesë dhe pakësim) të interesave pasurorë.

Pretendimi i subjektit se është lënë në heshtje një shumë e konsiderueshme *cash*-i në banesë, për shkak se nënkuptohet ekzistenca e tyre si derivat i tërheqjes apo deklarimit të transaksionit, është i paarsyeshëm dhe i pabazuar, pasi nuk përputhet me formimin profesional të subjektit dhe as me pretendimet për pasaktësi të paqëllimshme. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit, për mospasjen e dijenisë për mënyrën e deklarimit të likuiditeteve dhe pasojat që sjell mosdeklarimi i tyre, ka gjetur qëndrim të konsoliduar në vendimet e mëparshme të Kolegjit, për sa i përket arsyeve përse nuk ka vend për të parashtruar paaftësi për të kuptuar ligjin nga magjistratët<sup>21</sup>.

Ndër të tjera, Kolegji ka arsyetuar në praktikën e tij si vijon:

*“[85] Nga aktet në fashikull, e më konkretisht deklaratat periodike vjetore 2003-2016 dhe nga ajo vetting rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar që nga viti 2005 shtesa dhe pakësime të kësaj shume në banesë në zbatim të detyrimeve të parashikuara më sipër, që nënkupton ose që shuma në fjalë nuk është përdorur ose shtesat dhe pakësimet e saj nuk janë deklaruar, sipas ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar dhe ligjit nr. 84/2016”<sup>22</sup>.*

*“[19.4.vi] Pa përsëritur sa është arsyetuar më sipër, ndërsa deklaratimet periodike vjetore përbëjnë dokument zyrtar sipas ligjit dhe janë të vetmet referenca të ekzistencës së likuiditeteve *cash* jashtë sistemit bankar dhe kanë vlerë prove në procesin e rivlerësimit [në zbatim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016], analiza e deklaratës vetting dhe e shpjegimeve të subjekteve në proces përkundër deklaratave periodike është esenciale në vlerësimin e krijimit të pasurive në analizë të mundësive të krijimit me burime të ligjshme [...]”<sup>23</sup>.*

**18.4.** Nga praktika e konsoliduar e Kolegjit<sup>24</sup>, rezulton se, bazuar në ligjin nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, në nenin 4, germa “d”, parashikohet se subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në ILDKPKI vlerën e likuiditeteve, gjendjen *cash*, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj. Sipas kësaj dispozite, subjekti i rivlerësimit duhet të deklaronte vit pas viti gjendjen e likuiditeteve, për të mundësuar në këtë mënyrë kontrollin e pasurisë së tij. Neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 parashikon se deklaratimet e interesave privatë dhe pasurorë të paraqitura më parë te ILDKPKI-ja

<sup>20</sup>Të gjitha llojet e pasurive të luajtshme të regjistruara në regjistrat publikë, sendet me vlerë të veçantë 5.000 dollarë (ose i barasvlershmi i tij në lekë shqiptare), vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim, vlerën e likuiditeteve, gjendje në *cash*, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj, që disponon brenda dhe jashtë vendit zyrtari, bashkëshortja dhe fëmijët në moshë madhore.

<sup>21</sup>Shih, ndër të tjerë, vendimet e Kolegjit nr. 7/2019, paragrafi 39; nr. 11/2019, paragrafi 27.12.18; nr. 19/2019, paragrafi 84; nr. 20/2019, paragrafët 55 e 56 dhe nr. 29/2019, paragrafi 3.

<sup>22</sup>Vendimi i Kolegjit që i përket subjektit të rivlerësimit Xh. Z. JR nr. 19/2019. [https://kpa.al/wp-content/uploads/2019/10/Vendimi-Zh\\_Zaganjori-i-anonimizuar-perfshire-mendimin-paralel.pdf](https://kpa.al/wp-content/uploads/2019/10/Vendimi-Zh_Zaganjori-i-anonimizuar-perfshire-mendimin-paralel.pdf).

<sup>23</sup>Vendimi i Kolegjit që i përket subjektit të rivlerësimit D. P. JR nr. 27/2020. [https://kpa.al/wp-content/uploads/2020/12/Vendimi\\_Dritan-Peka\\_i\\_anonimizuar\\_per\\_web.pdf](https://kpa.al/wp-content/uploads/2020/12/Vendimi_Dritan-Peka_i_anonimizuar_per_web.pdf)

<sup>24</sup>Referuar jurisprudencës së Kolegjit në vendimet e juridiksionit të rivlerësimit nr. 8/2019, nr. 11/2019, nr. 19/2019, nr. 29/2019, nr. 1/2020, nr. 20/2020 dhe nr. 26/2022.

mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelit. Nuk mund të prezumohet përdorimi nga subjektet i gjendjeve *cash* si burime për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike. Aq më tepër, nuk mund të prezumohet ekzistenca e këtyre likuiditeteve, të cilat nuk janë deklaruar në deklaratat periodike prej subjektit, si e vetmja formë që mund të provonte ekzistencën e tyre.

Në rrethanat konkrete, rezulton se subjekti i rivlerësimit përgjatë viteve 2003-2015 ka deklaruar transaksionet e shitjeve të pasurive dhe vlerat e tyre, por nuk ka pasqyruar në formular gjendjet *cash* dhe ndryshimet që ato kanë pësuar, gjithashtu, nuk rezulton të ketë kryer ndonjë deklarim apo të ketë shpjeguar burimin e krijimit të pasurive dhe *cash*-it apo mënyrën sesi janë ruajtur të ardhurat e konsiderueshme në banesë, të cilat, sipas pretendimeve në hetimin administrativ, kanë mbetur të papërdorura në një sasi të konsiderueshme edhe disa vite pasi janë tërhequr. Trupi gjykues vlerëson se, në kushtet kur nuk ka ndonjë provë tjetër për identifikimin e të ardhurave të pretenduara të mbajtura në gjendje *cash*, institucionet e rivlerësimit e kanë të pamundur të gjurmojnë ekzistencën e shumave të pretenduara në vitet përkatëse, për rrjedhojë edhe përfshirjen e tyre në analizën financiare të viteve pasardhëse.

18.5. Në analizë të fakteve të mësipërme, trupi gjykues, duke analizuar në harmoni provat dhe aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, ka marrë në konsideratë vetëm deklarimin në deklaratën e interesave periodike të vitit 2016, për përdorimin e të ardhurave nga shitja e pasurisë në {\*\*\*}<sup>25</sup>. Pretendimet e tjera të subjektit të rivlerësimit, lidhur me gjendjen e *cash*-it, të padeklaruar në asnjë prej deklaratave periodike të viteve 2003-2015, posedimin në banesë të të ardhurave të përfituara, sipas tij, nga kursimet vjetore apo nga shitjet e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme ose përdorimin e tyre<sup>26</sup>, i vlerëson të pabazuara.

19. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me pasurinë e paluajtshme “tokë arë”, me sipërfaqe 2000 m<sup>2</sup>, ndodhur në {\*\*\*}, Tiranë dhe burimet e deklaruara për financimin e blerjes së saj, ka parashtruar pretendime të cilat analizohen në vijim.

19.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit për pamundësinë e krijimit të kësaj pasurie është i pasaktë dhe rezultat i një hetimi të paplotë në shkelje të parimit të ligjshmërisë dhe proporcionalitetit. Komisioni në mënyrë të padrejtë ka verifikuar mundësinë e krijimit të të ardhurave vetëm për sa i përket periudhës brenda vitit 2011, duke mos marrë në konsideratë ekzistencën e kursimeve ndër vite (për periudhën 2003-2011), pavarësisht se nuk janë deklaruar në deklaratat periodike përkatëse prej tij.

19.1/a. Subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji që të kryejë një hetim dhe verifikim të plotë, për sa i përket kursimeve që ka krijuar subjekti gjatë viteve 2003-2010, pasi, sipas tij, nga të ardhurat e ligjshme të siguruar nga pagat, aktiviteti bar-kafe dhe diferenca e shitblerjeve të pasurive,

<sup>25</sup>Të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë në {\*\*\*}, Tiranë, janë analizuar në paragrafin 22.8 të këtij vendimi në mënyrë të detajuar.

<sup>26</sup>Analizuar më poshtë në këtë vendim konkretisht: në paragrafin 21.9 të këtij vendimi për burimin e krijimit të automjetit “Mercedes-Benz”, me targë {\*\*\*} në vitin 2015, në paragrafin 20.15 të këtij vendimi për burimin e krijimit të pasurisë automjet tipi “Mercedes-Benz”, me targë {\*\*\*}, në paragrafin 19.7/dh të këtij vendimi për përdorimin e depozitës prej 20.000 eurosh.

rezulton me një balancë pozitive në vlerën prej 8.023.170 lekësh. Kjo shumë, sipas subjektit, është e mjaftueshme për të përballuar diferencën e çmimit prej 6.270.000 lekësh që është përdorur për të krijuar pasurinë me sipërfaqe 2000 m<sup>2</sup> të ndodhur në {\*\*\*}, Tiranë.

**19.2.** Komisioni, lidhur me këtë pasuri, ka arritur në përfundimin *se subjekti i rivlerësimit, për shkak të balancës negative prej 5.105.654 lekësh, nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar blerjen e truallit në {\*\*\*}, Tiranë, sipas parashikimit të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.*

**19.3** Me qëllim analizimin e këtij shkakut ankimi, trupi gjykues mori në analizë deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e rivlerësimit të pasurisë dhe deklaratën periodike vjetore të vitit 2011, lidhur me pasurinë objekt vlerësimi, nga ku rezultoi se:

**19.3/a.** Në deklaratën e rivlerësimit të pasurisë, subjekti ka deklaruar: *“Pasuri e paluajtshme tokë arë, pasuria nr. {\*\*\*}, sip. 2000 m<sup>2</sup>, {\*\*\*}, Tiranë. Vlera: 11.160.000 (njëmbëdhjetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë. Pjesa takuese: 100%. Kontratë blerje nr. {\*\*\*}, datë 16.09.2011. Burimi: (1) kursime nga pagat gjatë viteve; (2) kredi e marrë pranë Raiffeisen Bank; (3) të ardhura nga biznesi”.*

Në deklaratën e interesave periodike të vitit 2011, subjekti ka deklaruar: *“Kontratë shitblerje toke me sipërfaqe 2000 m<sup>2</sup> në fshatin {\*\*\*}, Tiranë, me çmimin 11.270.000 lekë, pjesa takuese 100%. Kontrata e shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 16.09.2011”.* Si burim krijimi, subjekti ka deklaruar: *“Për blerjen e kësaj toke kam përdorur përveç të ardhurave që i kam deklaruar në vitet e shkuara edhe një kredi nga Raiffeisen Bank në shumën prej 5.000.000 (pesë milion) lekësh, për një afat kohor prej 15 vjetësh”.*

**19.3/b.** Nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, rezulton se Agjencia Shtetërore e Kadastrës, me shkresën kthim përgjigje nr. {\*\*\*} prot., datë 24.06.2020, i ka përcjellë Komisionit dokumentacionin në të cilin ndodhet: certifikatë për vërtetim pronësie, lëshuar më datë 26.09.2011, ku rezulton e regjistruar në emër të Kolë Hysenaj pasuria nr. {\*\*\*}, e llojit arë me sipërfaqe 2000 m<sup>2</sup>, në {\*\*\*}, Tiranë; kontratë shitblerje nr. {\*\*\*}, datë 16.09.2011, nga e cila rezulton se Kolë Hysenaj ka blerë nga shtetasit B. e D. M., pasurinë me nr. {\*\*\*}, në vlerën prej 11.160.000 lekësh.

Megjithëse në këtë kontratë nuk është përcaktuar mënyra e likuidimit të shumës, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se vlerën e kësaj pasurie e ka likuiduar në *cash* në favor të shitësit B. M., duke paraqitur deklaratë noteriale<sup>27</sup> të këtij shtetasi, e cila konfirmon deklarin e subjektit.

**19.4.** Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren se Komisioni, në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë objekt shqyrtimi, ka përfshirë në analizën financiare:

a) Të ardhurat e dokumentuara dhe të deklaruara nga pagat e subjektit dhe bashkëshortes së tij nga data 1 janar 2011 deri në momentin e blerjes së pasurisë në shumën prej 1.305.539 lekësh.

---

<sup>27</sup>Deklaratë noteriale e shitësit B. M., nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 26.02.2020.

b) Kredinë<sup>28</sup> e marrë pranë “Raiffeisen Bank” më datë 28.07.2011, në vlerën 5.000.000 (pesë milion) lekë. Megjithëse nuk u vërtetua që kjo shumë të ketë kaluar në rrugë bankare në emër të shitësit të pasurisë objekt shqyrtimi, Komisioni e ka përfshirë shumën e përfituar nga kredia në analizën financiare si e ardhur e ligjshme për blerjen e pasurisë, duke mbajtur në konsideratë faktin që subjekti ka tërhequr *cash* në datën 29.07.2011 shumën e disbursuar të kredisë prej 4.913.400 lekësh dhe kontrata e shitjes është lidhur në datën 16.09.2011.

c) Të ardhurat e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit nga biznesi privat<sup>29</sup>, në aktivitetin bar-kafe, të deklaruara pranë organeve tatimore në shumën prej 312.708 lekësh deri në momentin e blerjes së pasurisë më datë 16.09.2011.

19.5. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit të ngritur për herë të parë vetëm në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, se si burim për krijimin e kësaj pasurie kanë shërbyer edhe të ardhurat e përfituara në vitin 2010 nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targë {\*\*\*}, përmes kontratës nr. 3361/2547, datë 19.07.2010, në çmimin prej 22.000 eurosh, trupi gjykues e vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit se ky burim nuk mund të konsiderohet si e ardhur e ligjshme pasi: (i) nuk është deklaruar sipas detyrimeve të legjislacionit përkatës në deklaratën e interesave periodikë të vitit 2011 dhe në deklaratën e rivlerësimit të pasurisë; (ii) nuk është depozituar nga subjekti në bankë, si dhe nuk është deklaruar prej tij si likuiditet në *cash* në fund të vitit 2010; (iii) është deklaruar si burim për blerjen e një automjeti tjetër të blerë në vitin 2015 (analizuar më poshtë në këtë vendim), ndërkohë që transaksionet dhe veprimet e kryera për blerjen dhe shitjen e këtij automjeti, trupi gjykues, ashtu si dhe Komisioni, i konsideroi si të kryera jashtë logjikës financiare.

19.6. Trupi gjykues konstaton se në ankimin e depozituar në Kolegj, lidhur me të ardhurat e kursyera ndër vite dhe mundësinë financiare të krijimit të pasurive të tij, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur të njëjtat vlera si ato që ka përlllogaritur edhe eksperti kontabël<sup>30</sup> i kontraktuar prej tij. Nga analizimi i këtij raporti auditimi, rezulton se është përdorur e njëjta metodologji për përlllogaritjen e shpenzimeve dhe të ardhurave si ajo e përdorur nga Komisioni, por në përlllogaritjet e tij, audituesi ka vlerësuar mundësinë e kursimit ndër vite të subjektit duke marrë në konsideratë shpjegimet e këtij të fundit. Në dallim nga Komisioni, rezulton se eksperti kontabël nuk i ka përlllogaritur të ardhurat e subjektit në raport me identifikimin e burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë, në momentin e krijimit të tyre, sipas kërkesave të ligjit nr. 84/2016.

19.7. Në ankimin e paraqitur në Kolegj, subjekti i rivlerësimit pretendon se tërheqja e shumës prej 20.000 eurosh në vitin 2010, krijuar si depozitë në “Tirana Bank” në të njëjtin vit, është përdorur pjesërisht për nevoja familjare (ushqim, veshmbathje, mobilim, pagesë kësti kredie, udhëtime etj.), ndërsa shumata e mbetur ka qëndruar si kursim *cash* dhe është përdorur për blerjen e tokës në {\*\*\*}, Tiranë, në vitin 2011. Trupi gjykues analizoi dokumentacionin e administruar gjatë

---

<sup>28</sup>Me kontratë kredie bankare dhe hipotekore nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 28.07.2011, subjekti Kolë Hysenaj dhe D. H., kanë marrë në “Raiffeisen Bank” kredi në shumën 5.000.000 lekë për përdorim konsumator me hipotekë, me afat 180 muaj.

<sup>29</sup>Me vendimin për regjistrimin si person fizik të datës 17.05.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, D. H. (bashkëshortja e subjektit) është regjistruar si person fizik për të ushtruar aktivitet privat në fushën bar-kafe.

<sup>30</sup>Subjekti ka paraqitur në Komision një raport auditimi të hartuar më datë 23.12.2019 nga eksperti kontabël E. S. i pajtuar nga subjekti i rivlerësimit



hetimit administrativ në Komision dhe deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me qëllim verifikimin e mundësisë së këtij burimi krijimi, pretenduar nga subjekti i rivlerësimit.

**19.7/a.** Nga shqyrtimi i provave rezulton se në deklaratën e interesave periodike të vitit 2010 lidhur me këtë depozitë, subjekti ka deklaruar se [...] nr. i llogarisë “Tirana Bank”, {\*\*\*} në emër të Kolë Hysenaj. Depozita fillestare ka qenë 20.000 euro. Tërheqjet janë bërë në kohë të ndryshme për nevoja familjare nga data 19.03.2010 deri më 04.06.2010, prej zotit D. Gj., si i autorizuar prej meje. Tërheqje që i ka bërë në emër dhe për llogarinë time.

**19.7/b.** I pyetur nga Komisioni për arsyen e kryerjes së veprimeve bankare në llogarinë e tij nga z. D. Gj., subjekti, në përgjigje të pyetësorit të dytë, ndër të tjera, ka deklaruar se [...] D. Gj. ka qenë ish-koleg i tij (aktualisht noter) me të cilin ka punuar në Prokurorinë e Rrethit Tiranë dhe me kërkesë të tij në vitin 2010 kanë hapur një llogari “{\*\*\*}”, në “Tirana Bank”, pasi këtij të fundit i nevojitej një vërtetim me qëllim pajisen me vizë. Për të vërtetuar pretendimin e tij, subjekti ka vendosur në dispozicion deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 24.12.2019, të këtij shtetasi, i cili konfirmon deklaratimet e subjektit.

**19.7/c.** Lidhur me krijimin e depozitës në shumën prej 20.000 eurosh, në “Tirana Bank”, trupi gjykues konstaton se në deklaratën e interesave periodike të vitit 2010, subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj depozite.

**19.7/d.** Lidhur me konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për depozitimin e shumës prej 20.000 eurosh në datën 09.09.2010, subjekti i rivlerësimit pretendon se si burim i krijimit të kësaj shume kanë qenë kursimet ndër vite dhe nëse analizohen të ardhurat nga biznesi për vitet 2007-2009 apo dhe nëse verifikohet mundësia për të kursyer për periudhën 2003-2010, ai do të mund të justifikonte krijimin e depozitës në shumën prej 20.000 eurosh.

**19.7/dh.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se për krijimin e kësaj depozite kanë shërbyer kursimet në vite, në kushtet kur subjekti nuk ka deklaruar kursime *cash* në deklaratat periodike të viteve paraardhëse, referuar detyrimit të parashikuar në nenin 4, germa “d” e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, trupi gjykues çmon se mbetet e paprovuar dhe në nivel deklarativ shuma e pretenduar si e kursyer ndër vite<sup>31</sup>.

**19.7/e.** Me qëllim verifikimin e pretendimit të subjektit të rivlerësimit se si burim për krijimin e depozitës në shumën prej 20.000 eurosh kanë shërbyer të ardhurat nga aktiviteti bar-kafe “{\*\*\*}”, Kolegji kontrollon analizën e Komisionit mbi të ardhurat e konsideruara nga ky aktivitet, bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga organet tatimore. Nga kontrolli i kryer për periudhën 01.01.2010-09.03.2010, trupi gjykues i Kolegjit konfirmon, si edhe Komisioni, se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën prej (-) 2.488.943 lekësh, për çeljen e depozitës prej 20.000 eurosh, në “Tirana Bank”.

**19.7/f.** Për rrjedhojë, trupi gjykues e vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për depozitimin e shumës 20.000

---

<sup>31</sup>Paragrafi 18 e në vijim i këtij vendimi.

euro në datën 09.03.2010, duke mos i konsideruar në këtë mënyrë ato si burim krijimi për blerjen e tokës në {\*\*\*}, Tiranë, në vitin 2011.

**19.8.** Trupi gjykues, në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit se ka pasur të ardhura të kursyera të deklaruara në deklaratimet periodike, konstatoi se në periudhën 2003-2009:

a) subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave periodike të vitit 2009 ka deklaruar *lekë shqiptare, konvertuar në euro së bashku me të ardhurat e viteve të mëparshme dhe ndodhen në Tirana Bank në llogari të Kolë Hysenajt, vlera: 1.800.000 (një milion e tetëqind mijë) lekë;*

b) bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në të njëjtën deklaratë kryen të njëjtin deklaram, por cilëson se [...] (për këtë shumë janë 12.857 euro) të tjerat euro janë të viteve të mëparshme të deklaruara më parë ( shiko deklarinin e vjetër) këto të ardhura janë siguruar nga aktiviteti privat bar-kafe “{\*\*\*}”, regjistruar më datë 17.05.2007;

c) në deklaratën e interesave periodike të vitit 2011 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se për blerjen e kësaj toke kam përdorur përveç të ardhurave që i kam deklaruar në vitet e shkuara edhe një kredi [...].

**19.8/a.** Pavarësisht se subjekti i rivlerësimit në deklaratimet periodike të viteve 2003-2008 nuk ka deklaruar gjendjen *cash*, nëse do të analizoheshin deklaratimet e mësipërme të tij, në harmoni me njëra-tjetrën dhe në një këndvështrim garantist, si dhe nëse deklaratimet e sipërcituara të vitit 2009 do të konsideroheshin si një vetëkorrigjim, lidhur me shumat e disponuara *cash* para këtij viti, ato mund të përfshiheshin në analizën financiare të vitit 2011, lidhur me burimet e krijimit të pasurisë tokë arë me sipërfaqe 2000 m<sup>2</sup> .

**19.8/b** Edhe në këtë qëndrim tejet garantist, duke konsideruar shumën 1.800.000 lekë si të ardhur nga kursime të akumuluar deri në fund të vitit 2009, përsëri subjekti i rivlerësimit në datën 16.09.2011, për blerjen e pasurisë tokë arë në {\*\*\*}, do të rezultonte me mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën (-) 2.333.984 lekë.

**19.9.** Në përfundim të këtij shkakui ankimi, lidhur me pasurinë tokë arë, me sipërfaqe 2000 m<sup>2</sup>, ndodhur në {\*\*\*}, Tiranë, Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlerën e konkluduar nga Komisioni prej (-) 5.105.654 lekësh, për të justifikuar krijimin e kësaj pasurie, në përputhje me parashikimet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

**20. Lidhur me pasurinë automjet tip “Peugeot”,** me targa {\*\*\*}, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni, për këtë pasuri dhe për automjetin tjetër me targa {\*\*\*}, të ardhurat e të cilit kanë shërbyer si burim për krijimin e automjetit tip “Peugeot”, ka vepruar në shkelje të parimit të proporcionalitetit dhe procesit të rregullt ligjor. Sipas subjektit, Komisioni ka analizuar vetëm të ardhurat nga paga dhe biznesi për periudhën 01.01.2013-01.07.2013, duke përjashtuar të ardhurat e ligjshme të siguruara nga shitja e pasurisë së paluajtshme të ndodhur në {\*\*\*}, Petrelë.

**20.1.** Komisioni arriti në përfundimin se *subjekti i rivlerësimit: (i) ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën e interesave periodike të vitit 2013, pasi nuk ka deklaruar burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e automjetit me targa {\*\*\*}, në shumën 10.000 euro gjatë këtij viti, për blerjen e të cilit nuk ka pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme; (ii) nuk justifikon me të ardhura të ligjshme blerjen e automjetit me targa {\*\*\*} në vitin 2014, në çmimin 14.000 euro, referuar*

germave “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016 dhe pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

**20.2.** Në funksion të analizimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues vëren se në lidhje me burimin e krijimit që ka shërbyer për blerjen e automjetit tip “Peugeot” më datë 30.01.2014, në çmimin prej 14.000 eurosh, si në ankimin e paraqitur në Kolegj, ashtu edhe në sqarimet e dhëna gjatë procesit të rivlerësimit<sup>32</sup>, si dhe në deklaratën e rivlerësimit të pasurisë, subjekti ka dhënë të njëjtat shpjegime, sipas të cilave ky automjet është paguar në këtë mënyrë: (i) 8.500 euro nga shitja e automjetit tip “Peugeot”, me targa {\*\*\*}; ndërsa (ii) diferenca prej 5.500 eurosh është paguar me këste në mënyrë periodike gjatë vitit 2014.

**20.3.** Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar: “Automjet tip “Peugeot”, me targa {\*\*\*}. Vlera: 14.000 euro. Pjesa takuese: 100%. Kontratë blerjeje nr. {\*\*\*} rep., datë 01.07.2013; kontratë shitblerjeje nr. {\*\*\*} rep., datë 30.01.2014; kontratë shitjeje nr. {\*\*\*}, datë 29.04.2014. Burimi i krijimit: (a) kursime familjare të pagës; dhe (b) të ardhura nga biznesi. Blerja e fundit e paguar me këste mujore”.

**20.3/a.** Në deklaratën e interesave periodike për vitin 2013, djali dhe vajza e subjektit të rivlerësimit kanë deklaruar: “Kontratë shitje automjeti nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 01.07.2013, me palë shitëse shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK dhe blerëse D. dhe D. H., kontratë e likuiduar në dorë në shumën 10.000 euro ose 1.410.000 lekë”. Nuk kanë deklaruar burim krijimi.

**20.3/b.** Në deklaratën e interesave periodike për vitin 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar blerjen e automjetit tip “Peugeot”, me targa {\*\*\*}, në emrin e D. dhe D. H., në vlerën prej 14.000 eurosh nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, likuiduar 8.500 euro nga shitja e automjetit, me targa {\*\*\*}, te shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, sipas kontratës së datës 29.04.2014 dhe pjesa tjetër likuiduar nga 1.000 euro çdo muaj pas datës së blerjes dhe 500 euro muajin e fundit.

**20.3/c.** DPShTRr-ja, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 26.04.2019, ka informuar Komisionin se automjeti tip “Peugeot”, me targa {\*\*\*}, është i regjistruar në emër të D. H. dhe D. H. blerë me kontratën nr. {\*\*\*}, datë 30.01.2014, prej shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, me çmim 14.000 euro, sipas mënyrës së pagesës së përcaktuar në kontratë<sup>33</sup>.

**20.4.** Nisur nga fakti se si burim për krijimin e pasurisë së luajtshme automjet tip “Peugeot”, me targa {\*\*\*}, subjekti ka deklaruar se kanë shërbyer të ardhurat nga shitja e automjetit tjetër tip “Peugeot”, me targa {\*\*\*}, trupi gjykues mori në shqyrtim dokumentacionin për këtë automjet nga ku rezultoi:

**20.4/a.** Me kontratë shitje automjeti nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 01.07.2013, automjeti tip “Peugeot”, me targa {\*\*\*}, i është shitur D. e D. H. nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, me çmimin prej

---

<sup>32</sup>Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2.

<sup>33</sup>Me kontratë nr. {\*\*\*}, datë 30.01.2014, D. e D. H. blejnë nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK automjet tip “Peugeot” nr. shasie {\*\*\*}, targë {\*\*\*} (mjete objekt shqyrtimi) sipas pagesës: “8500 euro vlerësohet automjeti marka Peugeot, me nr. shasie {\*\*\*} (mjete i sipërpërmendur), i cili do t’i shitet sërish shoqërisë {\*\*\*}. Diferenca prej 5.500 euro do të paguhet si vijon: 1.000 euro me firmosjen e kontratës dhe çdo muaj do të paguajë 1.000 euro deri në pagesën e plotë, duke nisur nga muaji mars 2014”.

10.000 eurosh, të cilat, sipas kontratës, do të paguhen me nënshkrimin e kësaj kontrate. Me kontratë shitje automjeti nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 29.04.2014, vërtetohet rishitja e mjetit tip “Peugeot”, me targa {\*\*\*}, shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, nga D. e D. H., me çmim 8.500 euro, i likuiduar jashtë zyrës noteriale.

Në deklaratën e interesave periodike të vitit 2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar blerjen e automjetit tip “Peugeot”, me targa {\*\*\*}, por nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie.

**20.5.** Trupi gjykues konstaton se Komisioni ka kryer fillimisht analizën për mundësinë e subjektit të rivlerësimit për blerjen e automjetit tip “Peugeot”, me targa {\*\*\*}, në vlerën 10.000 euro, për periudhën 01.01.2013-01.07.2013, e cila ka rezultuar me bilanc negativ në vlerën (-) 911.862 lekë.

**20.5/a.** Trupi gjykues vëren se, megjithëse Komisioni ka konkluduar për mungesë burimesh financiare për blerjen e automjetit tip “Peugeot”, me targa {\*\*\*}, shumën 8.500 euro të përfituar nga shitja e tij e ka konsideruar si pjesë e të ardhurave për blerjen e automjetit tip “Peugeot”, me targa {\*\*\*}, në vitin 2014, në vlerën prej 14.000 eurosh.

**20.5/b.** Referuar konkluzionit të Komisionit, për mungesë burimesh të ligjshme financiare për blerjen e automjetit në vlerën prej 10.000 eurosh në vitin 2013, do të duhej që edhe e ardhura e përfituar nga shitja e tij në vlerën 8.500 euro të mos konsiderohej si burim i ligjshëm për blerjen e automjetit tip “Peugeot”, me targa {\*\*\*}, në vitin 2014. Për të mos rënduar pozitën e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, ashtu si edhe Komisioni, vlerën 8.500 euro e konsideroi si të ardhur të ligjshme.

**20.6.** Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se në analizën e kryer për periudhën 01.01.2013-01.07.2013, për blerjen e automjetit “Peugeot”, me targa {\*\*\*}, në vlerën 10.000 euro, duhet të konsiderohet si e ardhur edhe shuma prej 135.000 USD, e arkëtuar nga shitja e pasurisë në {\*\*\*}, Tiranë, konsiderohet i pabazuar nga trupi gjykues pasi:

a) e ardhura nga shitja e truallit në {\*\*\*} nuk është deklaruar asnjëherë nga subjekti si burim krijimi për pasurinë autoveturë tip “Peugeot”;

b) në deklaratën e rivlerësimit të pasurisë e ardhura e përfituar nga shitja e truallit në {\*\*\*} është deklaruar si burim për blerjen e dy pasurive të paluajtshme në Korçë, për rrjedhojë deklarimi si burim për këtë pasuri gjatë procesit të hetimit administrativ në Komision konsiderohet si një përpjekje e tij për të justifikuar burimin për krijimin e kësaj pasurie.

**20.7.** Në këto rrethana, trupi gjykues e vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit për mospërfshirjen e shumës 134.900 USD, në analizën për verifikimin e mundësisë së subjektit për blerjen e automjetit tip “Peugeot”, me targa {\*\*\*}, si dhe në vlerësim të faktit se subjekti i rivlerësimit, përveç pretendimit për këtë të ardhur, nuk ka ankimuar asnjë zë të analizës së Komisionit.

**20.8.** Lidhur me burimin e ligjshëm të shumës prej 5.500 eurosh, paguar me këste gjatë vitit 2014, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare me të ardhura të ligjshme për ta paguar shumën e mbetur prej 5.500 eurosh deri më 30.06.2014, kur është paguar kësti i fundit për blerjen e automjetit, për shkak të një balance negative prej (-) 905.741 lekësh.

**20.9.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se ka pasur mundësi financiare për pagesën e shumës prej 5.500 eurosh gjatë vitit 2014, si këst për blerjen e automjetit tip “Peugeot”, me targa {\*\*\*}, duke kërkuar që nga analiza për përlllogaritjen e mundësisë për pagimin e shumës prej 5.500 eurosh në periudhën prill-qershor 2014 të mos përfshihej shpenzimi për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz” më datë 05.02.2014, në shumën prej 7.000 eurosh, pasi pagesa për të është financuar me kursimet më të hershme të paktën të një viti më parë<sup>34</sup>.

**20.10.** Trupi gjykues konstatoi se sa i takon pjesës së mbetur prej 5.500 eurosh, Komisioni ka kryer analizë për të verifikuar mundësinë financiare për pagimin e saj për periudhën 01.01.2014-30.06.2014, deri në datën e shlyerjes së këstit të fundit. Por duke qenë se më datë 05.02.2014 subjekti ka blerë në vlerën prej 7.000 eurosh automjetin tip “Mercedes-Benz”, me targa {\*\*\*}, kjo shumë është përfshirë si shpenzim i kryer deri më 30.06.2014, e cila ka afektuar rezultatin përfundimtar të analizës financiare, nga e cila subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën (-) 905.741 lekë.

**20.11.** Me qëllim verifikimin e burimit të ligjshëm të shumës prej 5.500 eurosh, paguar me këste gjatë vitit 2014, trupi gjykues analizoi dokumentacionin lidhur me automjetin tip “Mercedes-Benz”, me targa {\*\*\*}, nga i cili rezultoi se:

**20.11/a.** Me kontratë shitblerje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 05.02.2014, Kolë Hysenaj e djali i tij D. H. kanë blerë nga shitësi D. M. automjetin tip “Mercedes-Benz”, me targa {\*\*\*}, në vlerën prej 7.000 eurosh. Ndërsa me kontratë shitblerje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 26.11.2015, Kolë Hysenaj ia ka shitur këtë automjet blerësit Gj. S. me çmim shitjeje prej 15.000 eurosh.

**20.11/b.** Në deklaratën e interesave periodike të vitit 2014, konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa {\*\*\*}, ndërsa në deklaratën e interesave periodike të vitit 2015<sup>35</sup>, subjekti ka deklaruar kontratat e shitblerjes (të sipërcituara) të automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa {\*\*\*}, por nuk ka deklaruar burimin e krijimit, sipas detyrimeve ligjore të parashikuara në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003.

**20.12.** Pretendimin e subjektit të rivlerësimit se për të provuar mundësinë financiare të tij për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa {\*\*\*}, duhet të merren në konsideratë edhe të ardhurat nga kursimet e tij të viteve më përpara, nëpërmjet të cilave të mund të kontrollohej dhe vlerësohej mundësia e tij për blerjen e pasurisë së luajtshme automjet tip “Mercedes-Benz”, me targa {\*\*\*}, trupi gjykues e konsideron të pabazuar në vijim të qëndrimit më lart në këtë vendim<sup>36</sup> për mosdeklarimet e gjendjes *cash* apo likuiditeteve në deklaratat periodike ndër vite.

---

<sup>34</sup>Këto shpjegime, subjekti i rivlerësimit i ka dhënë në përgjigje të pyetësorëve dërguar nga Komisioni, por edhe në shpjegimet e rezultateve të hetimit administrativ. Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: “Referuar edhe datës së blerjes së tij, është më se logjike se blerja e tij kurrsesi nuk mund të jetë financuar vetëm me të ardhurat e muajit Janar 2014, por është financuar nga kursimet më të hershme, së paku të një viti më të hershëm. Për këtë arsye, blerja e këtij automjeti nuk mund të përfshihet në analizën financiare për periudhën janar-qershor 2014, sepse realisht shuma e paguar për blerjen e saj më 05.02.2014, nuk është financuar nga këto të ardhura”.

<sup>35</sup>Lidhur me këtë deklaram, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti ka shpjeguar se e ka harruar ta deklarojë blerjen e automjetit në vitin 2014 dhe e ka korrigjuar gabimin me deklaramin në vitin 2015.

<sup>36</sup>Paragrafi 18 e në vijim në këtë vendim.

Për rrjedhojë, shuma e përdorur për blerjen e automjetit “Mercedes-Benz”, me targa {\*\*\*}, ashtu si dhe Komisioni, është llogaritur si shpenzim në analizën financiare me të ardhurat e vitit 2014, duke sjellë si pasojë pamundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për pagesën e shumës prej 5.500 eurosh, si këst për blerjen e automjetit tip “Peugeot”, me targa {\*\*\*}.

**20.13.** Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues e konsideron të drejtë analizën e Komisionit për mundësinë e kryerjes së pagesës prej 5.500 eurosh, për krijimin e pasurisë automjet tip “Peugeot”, me targa {\*\*\*}, për periudhën 01.01.2014-30.06.2014, si dhe përfshirjen në zërin “shpenzim” në këtë analizë edhe të pasurisë automjet tip “Mercedes-Benz” blerë në datën 5.02.2014, në vlerën prej 7.000 eurosh ose 980.770 lekë. Për rrjedhojë, edhe në Kolegj, konfirmohet mungesa e burimeve financiare të ligjshme në shumën prej (-) 905.741 lekësh.

**20.14.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se mosdeklarimi i burimit të blerjes së automjeteve me targë {\*\*\*} dhe me targë {\*\*\*}, në deklaratat e interesave periodike të vitit 2013 dhe 2014, nuk ka pasur si qëllim fshehjen e burimit të tyre, pasi ato janë përfituar me akt publik noterial dhe të regjistruar në DPSHTRr-në Tiranë, prandaj pasaktësia e mosdeklarimit të tyre nuk mund të trajtohet në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

**20.15.** Trupi gjykues i Kolegjit vëren se deklarimi i pasaktë, i paplotë dhe/apo i pavërtetë në deklaratat e interesave privatë periodikë, lidhet drejtpërdrejt me përgjegjësinë që kanë subjektet deklaruuese për të përmbushur detyrimet ligjore të parashikuara nga ligji nr. 9049/2003. Pavarësisht se dokumentacioni për blerjen e automjeteve është i administruar dhe nuk përbën pengesë për organet e rivlerësimit për kontrollin e tyre, subjekti duhet ta kishte deklaruar burimin e tyre në deklaratat e interesave privatë periodikë, në vijim të detyrimeve ligjore që ka përcaktuar ligji nr. 9049/2003. Megjithatë kontrolli i saktësisë së plotësisë të deklaratave të interesave privatë periodikë vjetorë nuk është objekt i zbatimit të ligjit nr. 84/2016, me pasojë dhënien e masës disiplinore. Vlerësimi i përmbajtjes së tyre si prova bëhet vetëm në funksion të kontrollit të saktësisë së plotësisë nga subjektet e rivlerësimit, të deklaratës së rivlerësimit të pasurisë dhe verifikimit të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve përgjatë vitit përkatës.

**20.15/a.** Në kuadër të vlerësimit nëse një deklarim i pasaktë në deklaratën e interesave periodike vjetore mund të prodhojë pasojat e një deklarimi të pasaktë edhe në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, vërehet se neni D i Aneksit të Kushtetutës, neni 3, pika 11 dhe neni 30 i ligjit nr. 84/2016 dhe shtojca nr. 2 e tij, vendos për subjektin e rivlerësimit detyrimin për të deklaruar të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, të cilat janë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij.

**20.15/b.** Fakti që subjekti i ka deklaruar kontratat e shitblerjes së këtyre automjeteve, përbën një element që përjashton mundësinë e pasjes nga subjekti të ndonjë qëllimi për të manipuluar organet e kontrollit të pasurisë së tij, qoftë ato të kontrollit periodik apo ato të kontrollit për efekt të procesit të rivlerësimit. Kolegji çmon se ky element, i lidhur edhe me qëndrimet e mbajtura

tashmë nga jurisprudenca e Kolegjit<sup>37</sup>, pavarësisht pasaktësisë në deklarin periodik të vitit 2013 dhe 2014, nuk mund të jetë një rrethanë që e bën përgjegjës subjektin, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5 shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, nuk rezulton që Komisioni të ketë bërë një vlerësim të kësaj pasurie, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, në drejtim të përpjekjes së subjektit të rivlerësimit për të fshehur këtë pasuri.

**20.16.** Në përfundim të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, Kolegji vlerëson se për pasurinë automjet tip “Peugeot”, me targa {\*\*\*}, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

- 21. Lidhur me pasurinë automjet tip “SMART”, me targa {\*\*\*} /{\*\*\*},** subjekti i rivlerësimit pretendon se përfundimi i nxjerrë nga Komisioni, lidhur me mungesën e burimeve financiare për krijimin e pasurisë automjet tip “Mercedes-Benz”, me targa {\*\*\*}, i cili është shkëmbyer me automjetin tip “Smart”, me targa {\*\*\*}, të deklaruar në deklaratën e rivlerësimit të pasurisë, është marrë në interpretim të gabuar të ligjit dhe akteve shkresore të administruara. Sipas subjektit, mospërlllogaritja e të ardhurave nga shitja e automjetit në vitin 2010, për shkak të mospagimit të detyrimit tatimor në kohë reale dhe mosdeklarimit të kursimeve në fund të vitit 2010, nuk justifikojnë qëndrimin e Komisionit për të mos konsideruar këto të ardhura si burim për krijimin e automjetit të deklaruar në deklaratën e rivlerësimit të pasurisë.

**21.1.** Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, çmoi se *subjekti nuk arriti të kundërshtojë barrën e provës në lidhje me ligjshmërinë e të ardhurave në shumën prej 22.000 eurosh deklaruar për herë të parë në deklaratën vetting si burim për blerjen në vlerën 15.000 euro të automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa {\*\*\*} (ndryshuar në {\*\*\*}), në vitin 2015, mjet i këmbyer me mjetin tip “Smart”, me targa {\*\*\*}.*

Gjithashtu, Komisioni çmoi se *mosdeklarimi i burimit të krijimit të mjetit me targa {\*\*\*}, në deklaratën e interesave periodike të vitit 2015, nuk është thjesht një pasaktësi formale, po një pasaktësi që merr peshë specifike të posaçme në kushtet kur nuk u vërtetuan të ardhura të ligjshme për blerjen e tij. Në këto kushte, subjekti ka kryer deklarime të pasakta dhe ka pasur mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, në vitin 2015 dhe, për rrjedhojë, edhe për mjetin e këmbyer tip “Smart”, deklaruar në deklaratën vetting.*

**21.2.** Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Autoveturë tip Smart, targa {\*\*\*}. Vlera: 15.000 euro. Pjesa takuese: 100%. Kontratë blerje nr. {\*\*\*} rep., datë 12.02.2015. Kontratë shkëmbimi nr. {\*\*\*} rep., datë 07.10.2016. Burimi: Shitja e makinës ekzistuese të blerë në vitin 2008, ndërsa kontrata e dytë është shkëmbim mes dy automjeteve”.*

Në deklaratën e interesave periodike të vitit 2015, subjekti ka deklaruar: *“Kontratë shitblerje nr. {\*\*\*} rep., {\*\*\*} kol., datë 12 shkurt 2015, me palë shitës B. Ç. dhe blerës Kolë e D. H.(djali i subjektit), kjo në shumën 15.000 euro, likuiduar në dorë”.*

---

<sup>37</sup>Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 24/2021 (JR), datë 28.07.2021, nr. 25/2021 (JR), 29.07.2021 dhe nr. 33/2021 (JR), datë 03.11.2021.

Në deklaratën e interesave periodike të vitit 2016, subjekti ka deklaruar: *“Kontratë shkëmbimi nr. {\*\*\*} rep., datë 07.10.2016, autoveturë tip “Smart”, targa {\*\*\*}. Është shkëmbyer automjeti tip “Mercedes” i blerë në vitin 2015 me automjetin tip “Smart”, vetëm në emrin D. H.”.*

21.3. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi të automjetit “Smart”, këmbimin e tij me automjetin tip “Mercedes Benz”, me targë {\*\*\*} ( ndryshuar në targën {\*\*\*}), blerë në vitin 2015 në çmimin 15.000 euro, ndërsa, si burim për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, subjekti ka deklaruar shitjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targë {\*\*\*}, të blerë në vitin 2008. Trupi gjykues mori në shqyrtim dokumentacionin e administruar gjatë procesit të hetimit administrativ në Komision, me qëllim verifikimin e ligjshmërisë së burimit për blerjen e këtij automjeti, shitjen e tij në vitin 2010, blerjen e automjetit tjetër tip “Mercedes-Benz” në vitin 2015, si dhe shkëmbimin më pas të tij me automjetin tip “Smart”, me targë {\*\*\*}.

21.4. Trupi gjykues vëren se Komisioni në përfundim të hetimit administrativ, në lidhje me automjetin tip “Mercedes-Benz”, me targë {\*\*\*} blerë në vitin 2008, në çmimin 500.000 lekë, me kontratë shitje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 14.07.2008 dhe shitur në vitin 2010, në çmimin 22.000 euro, me kontratën nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 19.07.2010, konstatoi se:

i) Automjeti është blerë më datë 07.07.2008 prej shtetasit K. I., në çmimin 21.000 euro dhe në datën 11.7.2008 është zhdoganuar prej tij në vlerën 516.393 lekë.

ii) Në datën 14.7.2008, subjekti ka blerë këtë automjet nga shtetasi K. I., në çmimin 500.000 lekë në gjendje të rregullt teknike, sipas parashikimit në kontratën e shitjes, blerje të cilën e ka deklaruar në DPV-në e vitit 2008, por pa deklaruar burimin e krijimit të pasurisë, sipas nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar.

iii) Në datën 19.07.2010, automjeti u shit nga subjekti në çmimin 22.000 euro, pa u paguar tatimi mbi të ardhurat e përfuturara nga shitja e automjetit sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, në shumën 2.210.015 lekë/22.000 euro.

Referuar këtyre fakteve, duket se janë kryer veprime jashtë logjikës financiare dhe, për këtë arsye, mund të ngrihen dyshime që çmimi i shitjes së automjetit me kontratën nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 14.07.2008, duhet të ishte të paktën në shumën 21.000 euro+516.393 lekë zhdoganim, pothuajse aq sa subjekti e ka shitur 2 vjet më vonë.

21.5. Komisioni hetoi edhe në drejtim të një konflikti të mundshëm interesi të subjektit të rivlerësimit me shitësin e automjetit, nga ku rezultoi se nuk u konfirmuan kallëzime apo procedime penale të regjistruara e të trajtuara nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me shtetasin K. I.<sup>38</sup>.

Sa i takon një informacioni lidhur me një procedim penal në ngarkim të shitësit të automjetit K. I., Komisioni i kërkoi Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dosjen e plotë të procedimit penal të vitit 2014 për këtë shtetas. Në përgjigjen e saj kjo prokurori, ka informuar

<sup>38</sup>Shkresë kthim përgjigje nr. {\*\*\*} prot., datë 30.03.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, shkresë kthim përgjigje nr. {\*\*\*} prot, datë 03.03.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, si dhe shkresë kthim përgjigje nr. {\*\*\*} prot., datë 17.04.2020, nga SPAK, ndodhur në dosjen e Komisionit.



se<sup>39</sup> [...] për shtetasin K. I., procedimi penal nr. {\*\*\*} i vitit 2014, për veprën penale të “prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, e parashikuar nga neni 283/1 i KP, pa autor, është pezulluar për moszbulim të autorit të veprës penale dhe dosja është dërguar për hetime të mëtejshme në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, hetime të cilat i kryejnë oficerët e policisë gjyqësore në këtë drejtori.

**21.6.** Trupi gjykues, në funksion të kontrollit të vendimit të Komisionit, bazuar në shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit për këtë pasuri, verifikoi transaksionet e kryera për blerjen dhe shitjen e pasurisë automjet tip “Mercedes-Benz”, me targë {\*\*\*}.

Rezulton se në datën 07.07.2008, shtetasi K. I., ka blerë në Gjermani këtë automjet, në çmimin 21.000 euro. Me kontratën nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 14.07.2008, subjekti i rivlerësimit ka blerë automjetin e sipërcituar nga shtetasi K. I. në vlerën prej 500.000 lekësh, mjet të cilin subjekti e ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2008, por pa deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie.

**21.6/a.** Në procesverbalin e mbajtur me inspektorët e ILDKPKI-së në muajin qershor 2016, lidhur me çmimin e blerjes dhe të shitjes së automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targë {\*\*\*}, subjekti ka deklaruar se [...] shitësi K. I. ka qenë në pamundësi të kryerjes se procedurave të zhdoganimit për këtë automjet, pasi nuk kishte lekë të paguante doganën [...] të katërta dyert e makinës ishin të dëmtuara. Edhe pse ishte në rregull nga pikëpamja motorike ishte e papërdorshme nga pikëpamja gjenerike dhe, pasi është blerë, në periudha të ndryshme kohore i janë bërë disa herë servis në pjesë të ndryshme të porositura [...] me sa mbaj mend, servisi i kryer në momentin e blerjes, ka kushtuar rreth 300.000 lekë [...].

**21.6/b.** I pyetur nga Komisioni, lidhur me shkakun e blerjes së automjetit me targë {\*\*\*} në vlerën prej 500.000 lekësh nga shtetasi K. I., ndërkohë që mjeti ishte blerë prej tij rreth 22.000 euro<sup>40</sup> një javë para shitjes, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se këtë automjet e ka blerë të dëmtuar<sup>41</sup> dhe, pasi e ka riparuar, e ka shitur pas dy vitesh në vlerën prej 22.000 eurosh.

Në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se shtetasi K. I. është i afërmi i tij, duke sqaruar se në momentin e blerjes së mjetit ai ka qenë i karamboluar dhe në periudha vijuese ka kryer rregullime të pjesëve të ndryshme të tij. Sipas tij, K. I. kërkonte ta shiste automjetin, pasi do të shkonte të jetonte për disa kohë jashtë Shqipërisë.

**21.6/c.** Komisioni në datën 25.11.2020 ka pyetur në cilësinë e dëshmitarit shitësin e automjetit, z. K. I., i cili në dëshminë e tij<sup>42</sup> ka deklaruar se duke e mbajtur makinën në shtëpinë e tij të ndodhur në Laprakë, mbi të kishte rënë një degë peme, e cila kishte dëmtuar dy dyert makinës (derën e

<sup>39</sup>Shkresën nr.{\*\*\*} prot., datë 22.06.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, drejtuar IMO, në dosjen e Komisionit.

<sup>40</sup>Vlera 21.000 euro është ajo e blerë nga K. I. në Gjermani + 516.393 lekë vlera e zhdoganimit të automjetit.

<sup>41</sup>Në përgjigje të pyetjes nr. 5 të pyetësorit të datës 22.06.2020, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar Komisionin se me shitësin e automjetit K. I. ka lidhje familjare, konkretisht nëna e tij është vajza e xhaxhait e të atit të K. I. (kushërinj të parë)

Subjekti ka vënë në dispozicion deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr.{\*\*\*} kol, datë 26.02.2020 të shtetasit K. I., sipas së cilës konfirmohen deklaratimet e subjektit dhe se shitblerja e automjetit është kryer me vullnet të lirë dhe të plotë.

<sup>42</sup>Procesverbalin e pyetjes së dëshmitarit K. I., të datës 25.11.2020 në dosjen e Komisionit

*shoferit dhe pasagjerit), si dhe kabinën e makinës. I shqetësuar nga kjo ngjarje kishte dashur t'ia shiste sa më parë kujt do t'i jepte 500.000 lekë në dorë me qëllim që të blinte një tjetër, si dhe ka paguar doganën e më pas e kishte shitur automjetin.*

Ndërsa në datën 14.10.2020, Komisioni pyeti në cilësinë e dëshmitarit blerësin e automjetit G. H., i cili deklaroi se<sup>43</sup>, *pasi e ka kontaktuar z. Hysenaj në numrin e afishuar në makinën e tij (për shitje), e ka takuar vetëm një herë tek noteri, kur është bërë kontrata e shitblerjes së makinës, konfirmoi blerjen e makinës në shumën 22.000 euro, si dhe faktin se sipas tij makina ishte riparuar më parë, pasi ishte e lyer.*

**21.6/d.** Nga dokumentacioni i administruar rezultoi se: (i) në datën 07.07.2008, automjeti tip “Mercedes-Benz”, i vitit të prodhimit 2007, u ble në Gjermani nga K. I.; (ii) në datën 09.07.2008, automjeti hyri në Shqipëri nëpërmjet pikës kufitare të Hanit të Hotit; (iii) në datën 11.07.2008, është paguar dogana në Durrës në vlerën 516.393 lekë, nga K. I.; si dhe (iv) në datën 14.07.2008, u bë vërtetimi i kontrollit fizik të automjetit nga ku nuk rezultuan problematika dhe u nënshkrua kontrata e shitblerjes së këtij automjeti ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe shitësit K. I. me çmim shitjeje në vlerën prej 500.000 lekësh.

**21.6/dh.** Sikurse vërehet nga kronologjia e ngjarjeve të sipërcituara, dëmtimi i mjetit nga rënia e një dege peme dhe gjetja e blerësit për shitjen e makinës, kanë ndodhur brenda një periudhe shumë të shkurtër kohore (prej tre ditësh, nga data 11.07.2008 - 13.07.2008), ndërkohë në datën e shitjes së automjetit, më 14.07.2008, kur u krye kontrolli fizik i mjetit, nuk kanë rezultuar problematika. Komisioni verifikoi, gjithashtu, edhe lëvizjet hyrje-dalje të subjektit në sistemin *TIMS*, sipas së cilit ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar me këtë automjet jashtë shtetit në datën 01.08.2008, pra, mbetet e paqartë se si mjeti i papërdorshëm nga ana xhenerike, për të cilin ishin porositur pjesë këmbimi jashtë vendit, është bërë e mundur të qarkullojë jashtë shtetit pas 15 ditësh nga dita e blerjes.

**21.6/e.** Trupi gjykues konstatoi se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI dhe gjatë hetimit administrativ në Komision, lidhur me gjendjen e automjetit në momentin e blerjes së tij, bien në kundërshtim me parashikimet e kontratës së shitblerjes, datë 14.07.2008, sipas së cilës deklarohet se *shitësi e gëzon mjetin në gjendje të rregullt teknike*, si dhe me dokumentin e titulluar *certifikata e kontrollit fizik të mjetit*, e ndodhur në dosjen e DPSHTRr-së, më datë 14.07.2008, në të cilën citohet se *nuk janë konstatuar problematika*, duke konfirmuar atë çka parashikon kontrata e shitjes së mjetit. Për më tepër, deklaratimet dhe shpjegimet e subjektit në ILDKPKI dhe në Komision janë në kundërshtim me dëshminë e dhënë nga K. I., si për sa i përket pagesës së zhdoganimit, shkakut që ka sjellë dëmtimin e pretenduar të automjetit, si dhe llojin e këtyre dëmtimeve<sup>44</sup>.

---

<sup>43</sup> *Procesverbalin e pyetjes së dëshmitarit G. H., të datës 14.10.2020, në dosjen e Komisionit.*

<sup>44</sup> *Në seancën dëgjimore në Komision, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se automjeti kishte dy dyer të dëmtuara. Ndërkohë, shtetasi K. I. deklaroi se ishte dëmtuar kabina e makinës, si dhe dy dyert e para. Në deklaratimet e subjektit pranë ILDKPKI-së, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se e ka paguar ai doganën e këtij automjeti, ndërsa shtetasi K. I. në deklaratimet në Komision ka deklaruar se ka paguar doganën dhe më pas e ka shitur automjetin. Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, subjekti ka deklaruar se shitësi K. I. do të largohej nga Shqipëria dhe kishte vendosur për të jetuar dhe punuar disa kohë në Gjermani, ndërkohë nga deklaratimet e dëshmitarit dhe lëvizjet në*

**21.6/f.** Gjithashtu, nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore, trupit gjykues i rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shpenzime apo investime të kryera për riparimin e këtij automjeti të pretenduar të blerë të dëmtuar, riparuar më pas dhe shitur me vlerë më të lartë se çmimi i blerjes.

**21.6/g.** Nga të gjitha rrethanat e pasqyruara më lart, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime kontradiktore sa i takon gjendjes teknike të automjetit në kohën e blerjes, si dhe kostove të riparimit<sup>45</sup>, duke bërë të pabesueshme dhe jobindëse shpjegimet e tij lidhur me arsyet për të cilat ky automjet, me vit prodhimi 2007, është blerë në vitin 2008 me një çmim prej 500.000 lekësh. Për më tepër, trupi gjykues vlerësoi se shitja e këtij automjeti në vitin 2010 në vlerën e 22.000 eurove nuk justifikohet me shpenzimet e deklaruara si të kryera për riparimin e tij, duke e bërë të pabesueshëm faktin që ky automjet në momentin e blerjes së tij ka qenë i dëmtuar.

**21.6/h.** Trupi gjykues, gjithashtu, konstaton se kushtet e vendosura (çmimi) në kontratë janë në mënyrë disproporcionale me faktet që burojnë nga provat e administruara. Në këtë mënyrë, çmimi i vendosur në kontratën e shitblerjes së automjetit ndryshon në mënyrë thelbësore nga parimet e barazisë e të paanësisë të shprehura në dispozitat e Kodit Civil<sup>46</sup> që rregullojnë marrëdhëniet kontraktuale. Për rrjedhojë, gjendet i drejtë konkluzioni i Komisionit për këtë automjet se duket sikur janë kryer veprime jashtë logjikës financiare dhe, për këtë arsye, mund të ngrihen dyshime që çmimi i shitjes së mjetit me kontratën nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 14.07.2008, duhet të ishte minimalisht në shumën prej 22.000 eurosh, pothuajse aq sa e ka shitur subjekti i rivlerësimit këtë automjet dy vite më vonë.

**21.7.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se për sa kohë çmimet e blerjes dhe shitjes së automjeteve janë konfirmuar edhe nga shitësi K. I., por edhe blerësi G. H. dhe për to janë paguar detyrime tatimore<sup>47</sup>, të ardhurat e përfituara nga shitja e tyre janë të ligjshme dhe duhet të merren në konsideratë në analizën financiare për verifikimin e mundësisë për mbulim me burime financiare të ligjshme të automjeteve të sipërcituara, trupit gjykues, nga shqyrtimi i akteve të hetimit administrativ të administruar në Komision, i ka rezultuar se:

Drejtoria Rajonale Tatimore<sup>48</sup> i ka përcjellë Komisionit deklaratën individuale të vitit 2011, ku në rubrikën “*Të ardhura bruto të tjera të papërmenduar më lart*” është deklaruar shuma prej

---

*sistemin TIMS, rezultoi që pas shitjes së automjetit shtetasi K. I. ka pasur hyrje-dalje në periudha të shkurtra kohore jashtë shtetit dhe jo qëndrim të gjatë në Gjermani.*

<sup>45</sup>*Në seancën dëgjimore, ka deklaruar se shpenzimet për riparimin e automjetit kanë qenë 60.000 lekë, ndërsa në deklaratimet në ILDKPKI ka deklaruar shpenzime për riparimin e automjetit në vlerën 300.000 lekë, në parashtrimet e datës 18.03.2021, pas riçeljes së hetimit administrativ, deklaroi se këto shpenzime kanë qenë në vlerën 840.000 lekë.*

<sup>46</sup>*Nenin 686 i Kodit Civil paragrafi II citon se: “Janë të pavlefshme kushtet e përgjithshme që sjellin një humbje ose dëmtim të shpërpjesëtuar të interesave të palës kontraktuese, posaçërisht kur ato ndryshojnë në mënyrë thelbësore nga parimet e barazisë e të paanësisë të shprehura në dispozitat e këtij Kodi që rregullojnë marrëdhëniet kontraktuale”.*

<sup>47</sup>*Nëpërmjet vërtetimit nr. {\*\*\*} prot., datë 19.08.2020, të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë, subjekti i rivlerësimit pretendon se ka likuiduar të gjitha detyrimet e lindura nga shitja e automjeteve përkatësisht në vitet 2010, 2015 dhe 2016.*

<sup>48</sup>*Shkresë kthim përgjigje nr. {\*\*\*} prot., datë 12.02.2020, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.*

2.505.420 lekësh që korrespondon me vlerën e shitjes së automjetit dhe, gjithashtu, në këtë deklaratë është deklaruar tatimi në shumën 250.542 lekë. Kjo deklaratë e vitit 2011 është depozituar dhe plotësuar prej subjektit në datën 19.06.2019 dhe pagimi i tatimit mbi të ardhurat nga shitja është bërë në këtë datë, pra, pas depozitimit të deklaratës së rivlerësimit të pasurisë.

**21.7/a.** Trupi gjykues vlerëson se evidentimi i faktit nëse shuma prej 22.000 eurosh, e përfituar nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targë {\*\*\*}, konsiderohet si e ardhur e ligjshme, në zbatim të nenit 8 të ligjit nr. 8438 “Për tatimin mbi të ardhurat” dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006, të Ministrisë së Financave, nuk paraqet relevancë referuar rrethanave dhe fakteve të analizuar më lart në këtë vendim, lidhur me mënyrën e përfitimit të shumës prej 22.000 eurosh. Pagesa e detyrimeve tatimore për këtë shumë, qoftë edhe gjatë periudhës së hetimit administrativ, për të cilat Kolegji në vendimin nr. 15/2021 ka mbajtur qëndrimin e tij orientues<sup>49</sup>, nuk përbën elementin thelbësor në shqyrtimin e ligjshmërisë së kësaj të ardhure të përfituar nga subjekti i rivlerësimit nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targë {\*\*\*}, në vitin 2010. Trupi gjykues vlerëson se kjo e ardhur nuk mund të konsiderohet e ligjshme për arsyet e cituara në paragrafin 21.6/e, f, g dhe h të këtij vendimi, në të cilat veprimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit për blerjen dhe shitjen e këtij automjeti u konsideruan jashtë logjikës financiare.

**21.8.** Lidhur me automjetin tip “Mercedes-Benz”, me targë {\*\*\*} (ndryshuar targat në {\*\*\*}), shkëmbyer më pas me automjetin tip “SMART”, nga dokumentacioni i administruar rezultoi se:

**21.8/a.** Me kontratën nr. {\*\*\*}, datë 12.02.2015, djali i subjektit D. H. ka blerë automjetin tip “Mercedes-Benz”, prodhim i vitit 2004, me targa {\*\*\*}, me çmimin 15.000 euro.

Me kontratën nr. {\*\*\*}, datë 07.10.2016, subjekti i rivlerësimit dhe djali tij D. H. shkëmbejnë automjetin e sipërpërmendur tip “Mercedes-Benz”, me targa {\*\*\*}, me automjetin tip “Smart Coupe”, me targa {\*\*\*}, me vit prodhimi 2008, në pronësi të shtetasit F. S.. Sipas dokumentacionit<sup>50</sup>, rezulton se F. S. e ka blerë këtë automjet në shumën 800 euro në datën 23.05.2016.

**21.8/b.** Në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se shkëmbimi i automjeteve ka ndodhur në kushtet dhe gjendjen teknike që ato kishin në periudhën e shkëmbimit dhe transaksioni është kryer me vullnet dhe dëshirë të plotë të palëve. Mbi çmimin e automjeteve në momentin e shkëmbimit të tyre, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se *nuk mund të bëj dot vlerësime, por di të sqaroj se gjatë përdorimit prej më tepër se një vit e gjysmë, automjeti “Mercedes-Benz”, i përdorur nga djali im, pjesën më të madhe të kohës e ka kaluar në servis për shkak të defekteve të sjella, ndërsa automjeti tip “Smart”, vijon ende të jetë në përdorimin tonë familjar.*

---

<sup>49</sup>[...] në referim të nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në lidhje me pagesat me vonesë të detyrimeve tatimore, nëse ato do të mundësojnë legjitimitimin e të faqja 34 nga 55 ardhurave të krijuara, Kolegji çmon se vlerësimi i tyre do të duhet të bëhet duke konsideruar disa rrethana. Së pari, duhet që të provohet bindshëm vetë ekzistenca e të ardhurave në kohën e krijimit të tyre, pasi pagimi i detyrimit tatimor nuk mund të shërbejë si një mjet për të provuar krijimin e të ardhurave që nuk provohen me mjete të tjera. Së dyti, në konsideratë të organeve të rivlerësimit duhet të mbahet sjellja e subjektit apo e personave të lidhur dhe e personave të tjerë të lidhur në raport me mospagimin në kohë të detyrimit për të përcaktuar nëse mospagimi ka qenë pasojë e ndonjë pakujdesie apo paqartësie apo një qëllim për t'u arritur [...].

<sup>50</sup>Shkresë kthim përgjigje nr. {\*\*\*} prot., datë 26.04.2019, nga DPShTRr-ja në dosjen e Komisionit.

**21.8/c.** Trupi gjykues vëren se janë këmbyer dy mjete të blera me çmime shumë të ndryshme, përkatësisht 800 euro (automjeti tip “Smart Coupe”) dhe 15.000 mijë euro (automjeti tip “Mercedes-Benz”), me diferencë në blerje rreth 1 vit e gjysmë nga njëri-tjetri. Në kontratën e shkëmbimit nuk citohet ndonjë fakt mbi gjendjen teknike të mjeteve dhe shkaqet e këmbimit të dy pasurive me vlera të ndryshme, për rrjedhojë shpjegimet e subjektit të rivlerësimit duken jo bindëse, kur nuk ka paraqitur asnjë provë për të vërtetuar këto pretendime.

**21.9.** Lidhur me burimin e krijimit të automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targë {\*\*\*}, blerë në vitin 2015 në vlerën 15.000 euro, subjekti i rivlerësimit pretendon se duhet të konsiderohet si e ardhur e ligjshme shuma prej 22.000 eurosh e përfituar nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targë {\*\*\*}, në vitin 2010.

**21.9/a.** Komisioni ka vlerësuar se shuma prej 22.000 eurosh, përfituar në vitin 2010 prej shitjes së automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targë {\*\*\*}, blerë në vitin 2008, nuk mund të konsiderohet si burim i ligjshëm për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, në shumën 15.000 euro, në vitin 2015, vit i cili rezulton me balancë negative prej (-) 2.042.729 lekësh.

**21.9/b.** Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit kontratën nr. {\*\*\*}, datë 12.02.2015, për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targë {\*\*\*} (ndryshuar targat në {\*\*\*}) e ka deklaruar në deklaratën e interesave periodike të vitit 2015, por nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie, sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar si kursime gjendje *cash* në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010, shumën prej 22.000 eurosh përfituar nga shitja e mjetit me targë {\*\*\*}<sup>51</sup>, në vitin 2010 dhe as në deklaratimet në vijim deri në vitin 2015, vit në të cilin ka blerë mjetin me targë {\*\*\*}, sipas përcaktimit të nenit 4, pika “d” e ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar.

**21.9/c.** Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se e ardhura prej 22.000 eurosh e krijuar nga shitja e automjetit me targë {\*\*\*}, në vitin 2010 dhe e padeklaruar ndër vite, me të drejtë nuk është përfshirë nga Komisioni në analizën financiare për vitin 2015. Trupi gjykues, gjithashtu, e gjeti të drejtë qëndrimin e Komisionit për të mos e konsideruar atë si burim krijimi të ligjshëm për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targë {\*\*\*}, në shumën prej 15.000 eurosh, në vitin 2015, mbështetur edhe në konkluzionin në paragrafin 21/8 më sipër. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit konfirmon mungesën e burimeve financiare të ligjshme për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targë {\*\*\*}, në vitin 2015, në shumën (-) 2.042.729 lekë, aq sa është llogaritur nga Komisioni.

**21.10.** Në përfundim, duke qenë se automjeti tip “Mercedes-Benz”, me targë {\*\*\*} (ndryshuar targat në {\*\*\*}), me të cilin është shkëmbyer automjeti tip “Smart”, rezultoi me mungesë burimesh financiare të ligjshme, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe për pasurinë e fundit, me targë {\*\*\*}, ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

**22. Lidhur me pasurinë e paluajtshme “truall + ndërtesë”, me sipërfaqe 316 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Korçë, subjekti i rivlerësimit pretendon se si burim krijimi ka shërbyer depozita**

---

<sup>51</sup> Shitur me kontratën e shitblerjes së automjetit me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., më datë 19.07.2010.

bankare në shumën 128.000 euro, e cila është krijuar nga kursimet e periudhës 2011-2015. Sipas subjektit, për sa kohë vërtetohet mundësia e krijimit të shumës prej 128.000 eurosh dhe ligjshmëria e saj, është e panevojshme kryerja e analizës në datën e blerjes së pasurive.

Gjithashtu, subjekti kundërshton konstatimin e Komisionit se ka kryer deklarim të pasaktë për këto pasuri, pasi ashtu siç rezulton në DPV-në e vitit 2016 dhe në deklaratën e rivlerësimit të pasurisë, deklarimet e tij për mënyrën e krijimit dhe burimin e të ardhurave të ligjshme janë të plota, konsistente dhe në përputhje me nenin 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

Subjekti në ankim e konsideron të gabuar qëndrimin e dyzuar të Komisionit për përfshirjen ose jo të të ardhurave nga shitja e pasurisë së ndodhur në {\*\*\*}, Tiranë, pasi, sipas tij, kjo pasuri e blerë në vitin 2008 dhe e shitur në vitin 2012 përbën një të ardhur plotësisht të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

**22.1.** Komisioni, në përfundim të rezultateve të hetimit, ka konkluduar se referuar parashikimit të pikës 5 (germat “a” dhe “b”), të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016 dhe pikës 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pasakta dhe që vijnë në kundërshtim me ligjin, si dhe ka qenë në pamundësi financiare për blerjen e saj me të ardhura të ligjshme.

**22.2.** Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjyqës mori në shqyrtim dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ në Komision për këtë pasuri nga ku rezultoi se:

**22.2/a.** Në deklaratën e rivlerësimit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Pasuri e paluajtshme truall + ndërtesë, nr. {\*\*\*}. nr. {\*\*\*}, sip. 316 m<sup>2</sup>, Korçë. Vlera: 100.000 euro. Pjesa takuese: 100%. Kontratë shitblerje nr. {\*\*\*} rep, datë 13.07.2016; certifikatë për vërtetim pronësie nr. {\*\*\*}. Burimi: (1) kursime nga pagat; (2) shitja e truallit në {\*\*\*} te shtetasi A. P.; (3) të ardhura nga biznesi, të depozituara në bankë”.

**22.2/b.** Në deklaratën periodike për vitin 2016, subjekti ka deklaruar: “Pasuri e paluajtshme, truall+ndërtesë, pasuria nr. {\*\*\*} nr. {\*\*\*}, sip. 316 m<sup>2</sup>, Korçë, vlera 100.000 euro, pjesa takuese 50%. Burimi: (1) kursime nga pagat; (2) të ardhura nga biznesi në vite; (3) shitblerje të deklaruara në vite më përpara; (4) kursime të depozituara në bankë (sipas veprimit bankar të datës 01.07.2016), pagesa për shitblerjen sipas veprimit bankar të datës 13.07.2016”.

**22.2/c.** Agjencia Shtetërore e Kadastrës Korçë ka informuar Komisionin<sup>52</sup> se z. Kolë N. Hysenaj është bashkëpronar në ½ pjesë i pasurisë me nr. {\*\*\*}, me sipërfaqe totale 316,36 m<sup>2</sup>, nga të cilat 146,6 m<sup>2</sup> ndërtesë. Me kontratë shitblerje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 13.07.2016, subjekti Kolë Hysenaj ka blerë pasurinë nr. {\*\*\*}, me çmim 100.000 euro, vlerë e kaluar në llogarinë e noterit pranë BKT-së Korçë në datën 13.07.2016. Sipas certifikatës për vërtetim pronësie lëshuar nga ZVRPP-ja Korçë në datën 20.07.2016, pasuria nr. {\*\*\*} rezulton e regjistruar në bashkëpronësi të D. e Kolë Hysenaj me ½ pjesë takuese.

**22.2/d.** Në lidhje me burimin e krijimit për blerjen e kësaj pasurie në vlerën prej 100.000 eurosh, konstatohet se është përdorur llogaria numër {\*\*\*} në “Raiffeisen Bank”, ku subjekti ka pasur të

<sup>52</sup>Shkresë kthim përgjigje nr. {\*\*\*} prot., datë 21.05.2019, në dosjen e Komisionit.

depozituar shumën prej 128.000 eurosh. Këtë shumë subjekti i rivlerësimit e ka depozituar *cash* në datën 01.07.2016, me përshkrimin *nga biznesi, shitja e banesës në vitin 2012 dhe kursime nga pagat ndër vite*.

**22.3.** Duke marrë në konsideratë faktin se në deklaratën e rivlerësimit të pasurisë, por edhe në ankim subjekti i rivlerësimit deklaroi si burim kryesor për krijimin e pasurisë të ndodhur në Korçë, të ardhurat nga shitja e truallit të ndodhur në {\*\*\*}, Tiranë, trupi gjykues mori në analizë dhe vlerësoi dokumentacionin për këtë pasuri. Nga analizimi i deklarimeve të subjektit ndër vite, në lidhje me pasurinë në {\*\*\*}, Tiranë, rezultoi se:

**22.3/a.** Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2008, subjekti ka deklaruar: “1000 m<sup>2</sup> tokë “arë” në fshatin {\*\*\*}, Komuna Mullet, Tiranë, e blerë nga K. dhe T. B. në shumën 390.000 lekë, me kontratën e datës 07.04.2008, regjistri hipotekor nr. {\*\*\*}, Tiranë”.

**22.3/b.** Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2011, subjekti ka deklaruar: “Përfunduar ndërtimi i një shtëpie një kat me çati, me sip. 270 m<sup>2</sup> në pronën time me numër pasurie {\*\*\*} ndodhur në fshatin {\*\*\*}, komuna Petrelë, e cila është ndërtuar sipas lejes së ndërtimit nr. {\*\*\*} prot., datë 24.09.2008, por regjistrimi i kësaj banese nuk është bërë në ZVRPP, pasi jam në përfundim të procedurave në komunë për marrjen e lejes së përdorimit e më pas regjistrimin e banesës në ZVRPP-në Tiranë. Theksoj se ndërtimi investimi i saj ka përfunduar nga ana ime”.

**22.3/c.** Me kontratën e shitblerjes nr. {\*\*\*}, datë 07.04.2008, subjekti i rivlerësimit së bashku me bashkëshorten e tij D. H. kanë blerë nga K. e T. B. pasurinë tokë e llojit “arë” me sipërfaqe 1000 m<sup>2</sup> ndodhur në {\*\*\*}, Tiranë, me çmimin prej 390.000 lekësh.

**22.3/d.** Me kontratën e shitblerjes nr. {\*\*\*}, datë 20.01.2012, D. e Kolë Hysenaj i kanë shitur z. A. P. pasurinë me numër {\*\*\*}, {\*\*\*}, me sipërfaqe 1000 m<sup>2</sup> ndodhur në {\*\*\*}, Tiranë, kundrejt çmimit prej 14.170.000 lekësh.

**22.3/dh.** Nga analizimi i kontratës së shitblerjes<sup>53</sup> konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka shitur vetëm sipërfaqen e tokës prej 1000 m<sup>2</sup>, por edhe një ndërtesë njëkatëshe me sipërfaqe 71 m<sup>2</sup> të ngritur mbi të, e cila ka qenë e peregjistruar në ZVRPP. Lidhur me këtë ndërtim, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar<sup>54</sup> se mbi sipërfaqen e tokës së blerë prej tij është ndërtuar me investime të kryera prej tij një shtëpi me sipërfaqe 71 m<sup>2</sup>, e cila në vitin 2012 së bashku me sipërfaqen e tokës i është shitur shtetasit A. P..

**22.3/e.** Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore për vitet 2008 – 2010, rezultoi se subjekti rivlerësimit nuk ka kryer deklarime në lidhje me objektin e ndërtuar mbi tokën e blerë dhe as shpenzime apo pakësime likuiditetesh për kryerjen e investimeve. Ndërsa në deklaratën e interesave periodike të vitit 2011, subjekti ka deklaruar *përfunduar ndërtimi i një shtëpie një kat*

---

<sup>53</sup>Në kontratën e shitblerjes citohet se mbi tokën është ndërtuar një shtëpi njëkatëshe me çati, e cila është e peregjistruar në ZVRPP-në Tiranë”; dhe (ii) deklaratën noteriale të blerësit A. P., datë 30.03.2012, në të cilën ka deklaruar se ka shlyer detyrimin për shtëpinë dhe për tokën, ndaj shitësit Kolë Hysenaj.

<sup>54</sup>Leja e ndërtimit për këtë objekt është lëshuar në shtator të vitit 2008 në emër të shtetasit K. B. dhe kjo lidhet me faktin se aplikimi është realizuar përpara nënshkrimit të kontratës së shitblerjes, por banesa është ndërtuar për interes të tij si pronar i tokës dhe me shpenzime të tij.

me çati me sipërfaqe 270 m<sup>2</sup> në pronën time me numër pasurie {\*\*\*} ndodhur në {\*\*\*} e paregjistruar në ZVRPP.

22.3/f. Sikurse konstatohet, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratimet periodike vjetore vlerën e ndërtimit të këtij objekti, si dhe nuk ka deklaruar burimin e krijimit të tij, për rrjedhojë trupi gjykues e vlerëson të drejtë konstatimin e Komisionit se subjekti gjendet në kushtet e pasaktësisë në deklaratime përgjatë këtyre viteve, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003.

22.4. Nga analizimi i kontratave të shitblerjes të pasurisë tokë “arë”, pavarësisht shpjegimeve<sup>55</sup> të subjektit të rivlerësimit, konstatohet se janë kryer disa veprime që nuk përputhen me logjikën financiare, konkretisht rezultojnë se:

a) K. e T. B. ia kanë shitur fillimisht këtë pasuri subjektit në vitin 2008 (390.000 lekë) në një vlerë më të vogël se sa e kishin blerë në vitin 2004 (1.000.000 lekë)<sup>56</sup>.

b) Për të njëjtën pasuri (në {\*\*\*}, Tiranë), subjekti i rivlerësimit ka investuar në total vlerën 2.338.169 lekë (390.000 lekë për blerjen e tokës + 1.948.169 lekë investim në ndërtimin e objektit).

c) Këtë pasuri të krijuar në vitin 2008, subjekti ia shiti shtetasit A. P. në vitin 2012 në shumën 135.000 USD, sa shumëfishi i vlerës së investimit.

22.5. Trupi gjykues vëren se për sa i takon mundësisë financiare për blerjen e pasurive në Korçë me të ardhura të ligjshme, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit, pasi kreu analizën financiare në dy variante: (a) duke mos e përfshirë; dhe (b) duke e përfshirë shumën prej 134.900 USD, si gjendje likuiditetesh për periudhën 2013 – 2016. Sipas kësaj analize, viti 2016 rezultoi me një balancë negative në shumën prej (-) 16.704.238 lekësh në variantin e parë dhe në shumën prej (-) 2.893.176 lekësh në variantin e dytë. Komisioni vlerësoi se subjekti nuk arriti të kundërshtojë barrën e provës sa i takon burimit të të ardhurave të përfituara nga shitja e pasurisë në {\*\*\*}, Tiranë, të cilat nuk u përfshinë si të ardhura të ligjshme në analizën financiare përfundimtare të vitit 2016.

22.6. Subjekti i rivlerësimit pretendon se *kursimet përgjatë viteve kanë qenë reale dhe kanë shërbyer bashkërisht për krijimin e pasurive në vijimësi si edhe për përballimin e shpenzimeve të jetesës etj. Shuma prej 135.000USD, së bashku me kursimet ndër vite nga pagat dhe biznesi, pas shpjegimeve të dhëna në Inspektorat<sup>57</sup> dhe kërkesës së këtij të fundit për t'i arkëtuar në bankë të gjitha kursimet që disponoja, i kam depozituar ato në llogarinë time në “Raiffeisen Bank”, në*

<sup>55</sup>Lidhur me çmimet e vendosura në kontratë për këtë pasuri subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e dhëna në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka sqaruar se si pasojë e zhvillimit të zonës, ndërtimit të rrugës, qendrës tregtare {\*\*\*} dhe kthimi i statusit juridik të tokës nga lloji “arë” në “truall” është rritur vlera e kësaj pasurie.

<sup>56</sup>Lidhur me blerjen e tokës në 1/3 e çmimit që shitësi K. B. e kishte blerë, subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, ka deklaruar se [...] ka qenë interes i hershëm i tij blerja e një sipërfaqe toke dhe është vënë në dijeni se shtetasi K. B. donte të shiste një sipërfaqe toke prej 1000 m<sup>2</sup>, pasi donte të largohej në Norvegji, për t'u kuruar e jetuar atje, pasi vuante nga një sëmundje e rëndë. Shitblerja është kryer me vullnet të lirë [...].

<sup>57</sup>Në procesverbalin e datës 15.06.2016 pyetur nga ILDKPKI, subjekti ka deklaruar se pasi ka tërhequr këtë shumë (datë 05.03.2013, sipas dokumenteve bankare), e ka depozituar në kasafortën e banesës së vëllait P. H. dhe më pas e ka përdorur për nevoja të ndryshme të familjes e shpenzime të ndryshme dhe se pjesa e pashpenzuar ka qëndruar në kasafortë.



*Korrik të vitit 2016. Nga ky depozitim dhe mbi vlerën e këtyre kursimeve kam realizuar blerjen e dy pasurive në Korçë, në vlerën totale prej 125.000 eurosh.*

**22.7.** Në funksion të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi dhe njëkohësisht kontrollit të vendimmarrjes së Komisionit, lidhur me vlerësimin e shumës prej 128.000 eurosh, si një nga burimet e krijimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstaton fillimisht se është i nevojshëm analizimi i çështjes, nëse mosdeklarimi i shumave të tërhequra nga banka ( e ardhur nga shitja e pronës në {\*\*\*}) si gjendje *cash* në banesë, në deklaratimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI në vitet 2013, 2014 e 2015, mund të prodhojë pasojat e një deklarimi të pasaktë dhe të pamjaftueshëm e, për pasojë, të afektojë me paligjshmëri këtë burim krijimi.

**22.7/a.** Në deklaratën e interesave periodike për vitin 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Kontratë shitblerje toke me sip. 1000 m<sup>2</sup>, si dhe i një shtëpie 1 kat me çati, me sip. 70 m<sup>2</sup>, e ndërtuar mbi këtë pronë, nr. i pasurisë {\*\*\*}, ndodhur në fshatin {\*\*\*}, Tiranë, Komuna Petrelë. Kontrata e shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 26.01.2012. Vlera: 14.170.000 lekë. Shënim: Kjo shumë është likuiduar në “Raiffeisen Bank”, në datën 14 shkurt 2013”.*

Në deklaratën e interesave periodike për vitin 2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Likuiduar shuma prej 135.000 USD, vlerë që ka të bëjë me likuidimin e kontratës së shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} ko.l, datë 26.01.2012, kaluar në llogarinë rrjedhëse në USD në datën 14 shkurt 2013 (llogari bankare rrjedhëse në USD nr. {\*\*\*}, në emrin Kolë Hysenaj. Tërheqje nga llogaria personale në USD shuma prej 134.900 USD)”.*

**22.7/b.** Nga verifikimi në vijim i deklarimeve pranë ILDKPKI-së, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar likuiditete në bankë apo *cash* në deklaratën periodike vjetore për vitin 2013, vit gjatë të cilit tërhoqi shumën prej 134.900 USD, si dhe as në deklaratat vijuese të viteve 2014 dhe 2015.

**22.7/c.** Me qëllim verifikimin nëse pasaktësia për shkak të mosdeklarimit në deklaratimet periodike, si gjendje në *cash* e shumës së tërhequr nga banka, afekton deklarinin e subjektit në deklarinin e pasurisë së rivlerësimit, duke e bërë atë, përveçse të pasaktë, edhe të pamjaftueshëm, u analizuan faktet<sup>58</sup>, të cilat rezultojnë nga tërësia e akteve të administruara gjatë hetimit administrativ të kryer në Komision.

**22.8.** Trupi gjykues konstaton se mosdeklarimi i këtij fakti juridik (gjendja *cash*) nga subjekti i rivlerësimit në deklaratimet periodike nuk pamundëson institucionet e rivlerësimit për kontrollin dhe verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve të tij në deklaratën e rivlerësimit, lidhur me pasurinë e deklaruar dhe mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme për krijimin e saj, për sa kohë subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shitjen e pasurisë në {\*\*\*} bashkë me shumën e përfituar në deklaratën e interesave periodike të vitit 2012, si dhe tërheqjen e saj nga llogaria bankare në DPV-në e vitit 2013.

**22.8/a.** Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se pasaktësia e deklarimeve periodike, në rastin konkret, nuk përbën shkak për deklarim të pamjaftueshëm të pasurisë objekt kontrolli, deklaruar saktë e plotësisht në deklaratën e rivlerësimit, pasi nuk ka rezultuar asnjë e dhënë, sipas së cilës

---

<sup>58</sup>*Deklarimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike të viteve 2012 dhe 2013. Llogaritë bankare të subjektit mbi kalimin e shumës prej 135.000 USD dhe tërheqjen e saj. Deklarimet e subjektit në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI më datë 15.06.2016.*

mosdeklarimi i posedimit në *cash* të shumës prej 134.900 USD në vitet 2013-2015, si dhe përdorimi i saj në vitin 2016 të ketë shërbyer për fshehjen e veprimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë pasuri, në kundërshtim me detyrimet e tij, sipas legjislacionit në fuqi, për deklarimin e pasurive.

**22.8/b.** Gjithashtu, nga hetimi administrativ, nuk rezultoi e provuar që me këtë veprim (mosdeklarimin në deklaratat e viteve 2013-2015 të disponimit në *cash* të së ardhurës nga shitja), subjekti i rivlerësimit të ketë pasur si qëllim të mbajë jashtë vëmendjes dhe kontrollit të organit kompetent (ILDKPKI-së) këto pasuri dhe veprimet lidhur me to, në formën e deklarimit të rremë.

**22.8/c.** Pasuria “likuiditet *cash* në banesë” ka në origjinë dhe njëkohësisht burim krijimi marrëdhënien juridike të shitjes së pasurisë në {\*\*\*} të lidhur në vitin 2012, duke përbërë, për rrjedhojë një burim të ligjshëm i vlerësuar si i tillë edhe nga Komisioni.

**22.8/d.** Gjurmë të rrethanave faktike të pretenduara nga subjekti në deklaratën e rivlerësimit të pasurisë, gjenden jo vetëm në deklaratat periodike, por edhe në momentin e depozitimit të shumës prej 128.000 eurosh, në “Raiffeisen Bank”, në datën 01.07.2016, ku subjekti e ka kryer këtë veprim me përshkrimin *nga biznesi, shitja e banesës në vitin 2012 dhe kursime nga pagat ndër vite*, duke rezultuar kështu se deklarata e rivlerësimit nuk është i vetmi dokument në të cilin gjejnë pasqyrim këto fakte.

**22.9.** Pretendimin e subjektit të rivlerësimit se mosdeklarim i gjendjes *cash* përgjatë viteve 2003-2015 është një pakujdesi e tij në konceptimin që i ka bërë formularit të deklaratës së pasurisë, trupi gjykues e vlerëson në raport me faktin se subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë deklaruar në asnjë prej deklaratave periodike të viteve 2003-2015, gjendje *cash*, shtim apo pakësim të saj. Në ndryshim nga qëndrimi i mbajtur në jurisprudencën e Kolegjit, kjo gjendje *cash* nuk është krijuar prej kursimeve, të cilat, në kushtet e mosdeklarimit, gjenden në pamundësi për t’u provuar me mënyra të tjera, por ka ardhur sipas një burimi të mirëpërcaktuar siç është kontrata e shitjes së truallit. Vetëm pas mbajtjes së procesverbalit në ILDKPKI, në muajin qershor të vitit 2016, subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me mënyrën se si duhej konsideruar dhe plotësuar gjendja *cash*, rezulton se ka deklaruar për herë të parë në DPV-në 2016, gjendjen e likuiditetit në *cash*.

**22.9/a.** Rezulton se subjekti i rivlerësimit prej tërheqjes së shumës prej 134.900 USD në vitin 2013 deri në vitin 2016 nuk e ka deklaruar këtë shumë si gjendje *cash*, por e ka evidentuar si burim krijimi pasurie në DPV-në e vitit 2015 dhe në deklaratën e rivlerësimit të pasurisë. Trupi gjykues sjell në vëmendje jurisprudencën e Kolegjit<sup>59</sup> në raste të ngjashme kur janë verifikuar deklaratimet e kredive apo likuiditeteve, të rrjedhura nga burime të ligjshme të krijimit të pasurive, për të cilat subjektet e rivlerësimit nuk kanë deklaruar disponimin e tyre *cash*<sup>60</sup> në banesë në fund të vitit, të cilat janë identifikuar në deklaratimet e mëpasshme si burim krijim pasurish. Vlera e lartë dhe mungesa e investimeve dhe shpenzimeve të tjera, gjatë kësaj periudhe, i japin besueshmëri faktit se kjo shumë është mbajtur për t’u përdorur prej subjektit të rivlerësimit si burim për blerjen e pasurisë në Korçë jo shumë larg kohës së përfitimit të saj.

---

<sup>59</sup>Vendimi nr. 33/2021 (JR), datë 03.11.2021, paragrafi 44; vendimi nr. 37/2021 (JR), datë 24.11.2021, paragrafi 10.25 dhe vendimi nr. 20/2022, datë 14.06.2022, paragrafi 14.

<sup>60</sup>Të ardhura të padeklaulara si gjendje *cash*, por të cilat janë të mundshme të krijohen, si dhe që janë të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

Për sa analizuar më lart, trupi gjykues konkludoi se të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë në {\*\*\*}, Tiranë, të cilat kanë shërbyer si burim krijimi për pasurinë objekt shqyrtimi duhet të përfshihen në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit.

**22.10.** Bazuar në këtë konkluzion të Kolegjit, u korrektoja analiza financiare e Komisionit duke konsideruar si të ardhur të ligjshme shumën prej 134.900 USD, të përfituar nga shitja e pasurisë në {\*\*\*}. Me marrjen në konsideratë të kësaj shume, në përputhje me pretendimin e subjektit, nga përlllogaritjet e Njesisë së Shërbimit Ligjor në Kolegji, rezultojnë se subjekti i rivlerësimit përsëri do të mbetet me mungesë burimesh të ligjshme financiare për krijimin e kësaj pasurie.

Për rrjedhojë, për pasurinë nr. {\*\*\*}, me sipërfaqe totale 316,36 m<sup>2</sup>, nga të cilat 146,6 m<sup>2</sup> ndërtesë, ndodhur në Korçë, rezultojnë se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

**23. Lidhur me pasurinë e paluajtshme “truall + ndërtesë”, me sip. 50,90 m<sup>2</sup>,** ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Korçë, subjekti i rivlerësimit paraqet në ankim të njëjtat argumente si për pasurinë tjetër nr. {\*\*\*} ndodhur në Korçë, duke pretenduar se të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë ndodhur në {\*\*\*}, Tiranë, në vitin 2013, duhen të konsiderohen të ligjshme, pavarësisht faktit të mosdeklarimit të tyre si gjendje *cash* në DPV-të 2013, 2014 dhe 2015. Sipas subjektit, kursimet e viteve 2011-2015 (duke përfshirë dhe shitjen e pasurisë në {\*\*\*}, Tiranë), janë depozituar në bankë në korrik të vitit 2016 dhe kanë shërbyer për krijimin e pasurive në Korçë, në vlerën totale prej 125.000 eurosh, përkatësisht 100.000 euro për pasurinë nr. {\*\*\*} dhe 25.000 euro për pasurinë me sipërfaqe 50,90 m<sup>2</sup>.

**23.1.** Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, konkludoi se *duke qenë se si burim krijimi të pasurisë nr. {\*\*\*}, në Korçë, janë deklaruar të njëjtat burime si për pasurinë nr. {\*\*\*}, në Korçë, si dhe në kushtet kur të dyja pasuritë janë blerë në vitin 2016, analiza financiare për të dyja pasuritë është pasqyruar në të njëjtën tabelë dhe, për rrjedhojë, arriti në përfundimin se subjekti nuk ka pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie.*

**23.2.** Nga analizimi i dokumentacionit ndodhur në fashikujt e Komisionit, rezultojnë se ashtu sikurse për pasurinë tjetër ndodhur në Korçë, analizuar më lart, subjekti ka deklaruar në deklaratën e rivlerësimit të pasurisë edhe në deklaratën periodike vjetore për vitin 2016 të njëjtat të ardhura që kanë shërbyer si burim krijimi për këtë pasuri, konkretisht: (i) të ardhura të kursyera nga pagat ndër vite; (ii) kursime nga shitja e pasurisë së paluajtshme të ndodhur në {\*\*\*}, Tiranë; dhe (iii) të ardhura të kursyera nga biznesi ndër vite, të ardhura këto të akumuluar, të cilat janë depozituar në bankë.

**23.2/a.** Me kontratë shitblerje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 04.10.2016, subjekti i rivlerësimit ka blerë pasurinë nr. {\*\*\*}, me çmimin 25.000 euro, vlerë e kaluar në llogarinë e noterit në BKT-në Korçë. Me certifikatën për vërtetim pronësie nr. {\*\*\*}, datë 18.10.2016, pasuria me nr. {\*\*\*} rezultojnë e regjistruar në bashkëpronësi të D. e Kolë Hysenaj.

**23.2/b.** Në kushtet kur edhe për këtë pasuri si burim kryesor për krijimin e saj subjekti i rivlerësimit pretendon se kanë shërbyer të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë në {\*\*\*}, Tiranë, në vitin

2013, të cilat subjekti nuk i ka deklaruar si gjendje *cash*, vlen i njëjti arsyetim mbi mënyrën e trajtimit të këtyre të ardhurave, si për pasurinë tjetër nr. {\*\*\*}, me sipërfaqe totale 316,36 m<sup>2</sup>, nga të cilat 146,6 m<sup>2</sup> ndërtesë, ndodhur në Korçë, analizuar në paragrafin 22.9 të këtij vendimi.

**23.3.** Në përfundim, për pasurinë “truall + ndërtesë”, me sipërfaqe 316 m<sup>2</sup> dhe për pasurinë “truall + ndërtesë”, me sipërfaqe 50,90 m<sup>2</sup> ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Korçë, Kolegji vlerëson se, duke konsideruar vetëm të ardhurat e përfituara në vitin 2013 nga shitja e pasurisë në {\*\*\*}, subjekti i rivlerësimit gjendet sërish në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

Mungesa e burimeve financiare për krijimin e pasurive në Korçë, në ndryshim nga Komisioni, i cili e ka llogaritur në vlerën (-) 2.893.176 lekë (në variantin kur e ka përfshirë në analizë financiare të ardhurat e përfituara nga pasuria e ndodhur në {\*\*\*}, Tiranë), në llogaritjet në Kolegj kjo shumë është reduktuar në (-) 2.502.075 lekë, pasi janë marrë në konsideratë disa pretendime të subjektit të rivlerësimit që tregohen më poshtë në këtë vendim, në kuadër të kontrollit të analizës financiare për vitin 2016.

- 24. Lidhur me analizën financiare për periudhën 2003-2016,** Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën prej (-) 23.125.856 lekësh për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve gjatë kësaj periudhe. Komisioni paraqet edhe një rezultat alternativ me mungesë burimesh (-) 9.632.538 lekë, duke konsideruar të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë në fshatin {\*\*\*}, Tiranë, si gjendje *cash* në fund të vitit 2013, e cila nuk ka ndryshuar në vitet 2014 dhe 2015 dhe është përdorur në vitin 2016 për blerjen e pasurive në qytetin e Korçës.

**24.1.** Subjekti i rivlerësimit, në shkaqet e paraqitura në ankimit e tij për analizën financiare të kryer nga Komisioni për periudhën 2003-2016, ka ngritur pretendime për zëra të veçantë të analizave vjetore, duke kërkuar nga Kolegji të merren në konsideratë arsyetimet dhe dokumentacioni për të cilin pretendon se nuk është vlerësuar dhe referuar nga ana e Komisionit.

- 25.** Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar që të zbriten shpenzimet e udhëtimit të tij në ShBA në vlerën prej 1.280 eurosh në vitin 2004, pasi ky shpenzim është mbuluar nga shërbimet konsullore të ambasadës së ShBA-së për trajnimin e organizuar nga Departamenti i Shtetit dhe është pajisur me certifikatë.

**25.1.** Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues verifikoi dokumentacionin e ndodhur në fashikujt e përcjellë nga Komisioni nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar *Certifikatë Trajnimi nga Departamenti Amerikan i Shtetit & Viza e lëshuar nga Ambasada Amerikane, shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 11.12.2020, e Prokurorisë së Përgjithshme, e-mail, datë 23.09.2020, i zyrës së Konsullatës së Ambasadës së ShBA-së<sup>61</sup>*, dokumentacioni i cili konfirmon pretendimin e subjektit për shpenzimet e kryera për këtë udhëtim.

---

<sup>61</sup>Drejtoresha e programit A. P., e cila konfirmon pjesëmarrjen e subjektit Kolë Hysenaj në “Programin e lidhshëm të vizitorit ndërkombëtar” organizuar nga Departamenti i shtetit për periudhën 26 shtator-16 tetor 2004 dhe konfirmon se të gjitha shpenzimet e qëndrimit, akomodimit dhe udhëtimit janë mbuluar nga organizatorët.

25.2. Trupi gjykues, pasi verifikoi shpenzimet e udhëtimit të subjektit të rivlerësimit, konstatoi se Komisioni ka marrë në konsideratë këtë pretendim të subjektit dhe e ka reflektuar atë në analizën përfundimtare në vendimin e arsyetuar, duke e ndryshuar këtë zë të shpenzimeve, nga 223.062 lekë të llogaritur në rezultatet e hetimit administrativ, në 60.835 lekë.

26. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për mosllogaritjen si detyrim të shumës së dhënë hua nga vëllai i tij, pasi kjo hua është falur prej tij, trupi gjykues, pasi verifikoi deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave periodike dorëzuar në ILDKPKI, i rezultoi se në deklaratën e interesave periodike të vitit 2005, subjekti ka deklaruar *shlyerjen e detyrimit në shumën 100.000 lekë dhe i mbeten për të shlyer edhe 200.000 lekë*, ndërsa në deklaratën e interesave periodike të vitit 2006 ka deklaruar *një detyrim të prapambetur prej 200.000 lekësh vëllait P. H., por vëllai nuk ja ka pranuar pasi ja ka falur*. Në mbështetje të deklaratimeve të tij, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 23.01.2020, të vëllait të tij, i cili konfirmon faljen e të gjithë huas prej 300.000 lekësh subjektit të rivlerësimit.

26.1. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se për sa kohë shuma prej 100.000 lekësh është deklaruar nga subjekti si e shlyer gjatë vitit 2005, me të drejtë është përfshirë nga Komisioni në zërin shpenzime, në analizën financiare të këtij viti. Sa i takon vitit 2006, konstatohet se Komisioni në analizën e tij financiare krahas zërit detyrime hua nga vëllai P. H. në vlerën (-) 200.000 lekë, në zërin të ardhura ka vendosur vlerën 200.000 lekë si hua të falur nga vëllai. Referuar këtij veprimi kontabël, konstatohet se Komisioni e ka konsideruar të falur huan prej 200.000 lekësh në vitin 2006, në përputhje me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, për rrjedhojë pretendimi i tij është i pabazuar.

Subjekti i rivlerësimit kërkon të rillogariten të ardhurat nga aktiviteti bar-kafe “{\*\*\*}”, të bëhen reflektimet për të gjithë periudhën 2007-2016 për shumat e deklaruara në organet tatimore dhe për të cilat është paguar detyrimi përkatës. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti ka depozituar gjatë hetimit administrativ në Komision dokumentacionin<sup>62</sup> përkatës.

26.2. Me qëllim analizimin e këtij shkakut ankimi, u verifikuan deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, nga ku rezultoi se në deklaratën e rivlerësimit të pasurisë, në rubrikën “*Përshkrimi i të ardhurave*” ka deklaruar *aktiviteti privat bar-kafe “{\*\*\*}” person fizik D. H. (bashkëshortja ime), me {\*\*\*}, datë 18.06.2019. Lokal i marrë me qira shtetases T. D.. Vlera: 6.011.459 (gjashtë milion e njëmbëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë mijë) lekë*.

---

<sup>62</sup>Shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 03.12.2020, e Bashkisë Tiranë, e cila informon se qarkullimi vjetor i realizuar është deri në 2.000.000 lekë dhe konfirmon pagesën e detyrimeve të tarifave dhe taksave vendore për vitet 2007-2014; shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 30.12.2020, e DRT-së Tiranë; ekstrakt historik nga QKB-ja për Personin Fizik bar-kafe “{\*\*\*}”, në të cilin nuk evidentohet ndryshimi i statusit në “pasiv” nga data e themelimit deri më 15.03.2021 (data e printimit të këtij ekstrakti); njoftim mbi detyrimet për pagesën e tatimeve dhe taksave nga bar-kafe “{\*\*\*}” dhe mandatpagesat e shlyerjes së këtyre detyrimeve, për vitet 2007-2014; kontratë noteriale qiraje, datë 12.01.2020, me afat 2-vjeçar, midis shtetaseve T. D. dhe D. H., për ambientin 76 m<sup>2</sup>, në adresën {\*\*\*}, Tiranë; ekstrakt elektronik nga OSHEE-ja për pagesat e energjisë elektrike për përdoruesen T. D. (pronare e dyqanit); shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 16.03.2021, e OSSH-së, e cila informon për historikun e konsumit të energjisë elektrike për periudhën maj 2007-dhjetor 2020, për konsumatorin T. D.; kopje të librezës së UKT-së me konsumin e ujit dhe pagesat për vitet 2010-2012 për konsumatorin T. D..

**26.3.** Trupi gjykues vëren se Komisioni në rezultatet e hetimit administrativ, për shkak të mungesës së informacionit për fitimin e vitit 2007, në përlllogaritjet e tij kishte marrë për bazë mesataren e normës së fitimit të 3 viteve për aktivitetin e bar-kafe “{\*\*\*}”. Në procesverbalin e kontrollit të mbajtur në ILDKPKI<sup>63</sup> të datës 15.06.2016, së bashku me përgjigjet e pyetjeve të dhëna nga subjekti, gjenden bashkëlidhur edhe pasqyrat financiare për veprimtarinë private të bar-kafe “{\*\*\*}” për periudhën 2007-2014. Trupi gjykues konstatoi se në pasqyrën financiare të dorëzuar për vitin 2007 fitimi i përlllogaritur nga ekonomistja e bar-kafe “{\*\*\*}” është 1.080.000 lekë, aq sa është pasqyruar edhe në analizën e Komisionit.

**26.4.** Nga analizimi i vendimit<sup>64</sup> objekt shqyrtimi, rezulton se Komisioni ka vlerësuar se subjekti arriti të kundërshtojë barrën e provës dhe ka marrë në konsideratë në analizën financiare përfundimtare të ardhurat nga bar-kafe “{\*\*\*}” për vitet 2007 – 2016, sipas pretendimeve të subjektit, në shumën prej 5.986.459 lekësh. Sikurse konstatohet më lart, rezulton se të ardhurat nga aktiviteti bar-kafe “{\*\*\*}” janë përlllogaritur nga Komisioni në vlerë pothuajse të përafërt me shumën e deklaruar nga vetë subjekti në deklaratën e rivlerësimit të pasurisë, për rrjedhojë pretendimi i subjektit është i pabazuar.

**27.** Subjekti i rivlerësimit kërkon të reduktohen shpenzimet e udhëtimit të djalit të tij, në Itali, në datat 31.03.2007-09.04.2007, pasi kostoja e këtij udhëtimi përbëhet vetëm nga çmimi i biletës, ndërsa ushqimi dhe akomodimi janë përballuar nga daja i tij me banim në Itali, T. F.. Subjekti kërkon që shpenzimet e udhëtimit të llogaritura nga Komisioni në shumën 84.637 lekë, të reduktohen në shumën 36.273 lekë.

**27.1.** Trupi gjykues, në funksion të shqyrtimit të këtij shkak ankimi, pasi verifikoi dokumentacionin<sup>65</sup> e administruar gjatë hetimit administrativ, vëren se Komisioni në analizën financiare përfundimtare e ka marrë në konsideratë pretendimin e subjektit dhe e ka reflektuar ndryshimin në analizën e zërit të shpenzimeve të udhëtimit nga vlera 84.637 lekë, në 41.109 lekë, duke ju referuar në këtë mënyrë standardit<sup>66</sup> të përlllogaritjes së shpenzimeve<sup>67</sup> në Kolegj, për rrjedhojë pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

**28.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, i cili kërkon të reduktohet kosto e ndërtesës së banesës njëkatëshe me sipërfaqe 71 m<sup>2</sup>, sipas vlerës së përcaktuar në aktin e kolaudimit, kjo vlerë të shpërndahet përgjatë viteve 2008-2009, në masën  $\frac{3}{4}$  e kostos në vitin 2008 dhe  $\frac{1}{4}$  e kostos në

---

<sup>63</sup>Shkresa nr. {\*\*\*} prot., e ILDKPKI-së, dërguar Komisionit, bashkëlidhur së cilës gjendet procesverbali i kontrollit të datës 15.06.2016 dhe dokumentacioni justifikues i subjektit, në përgjigje të pyetjeve.

<sup>64</sup>Paragrafi 100.13 në faqen 53 të vendimit.

<sup>65</sup>Në këtë deklaratë lëshuar para autoriteteve zyrtare italiane (prefektura Anconës), me vulë apostile, më datë 16.07.2009, vëllai i gruas së tij T. F. (rezident prej vitësh në shtetin italian) deklaroi se motra e tij D. H. bashkë me familjen e saj (fëmijët dhe bashkëshorti) janë akomoduar me ushqim dhe fjetje në shtëpinë e tij gjatë qëndrimit të tyre në Itali, duke specifikuar edhe periudhat përkatëse. Ekstrakt i të ardhurave të tatuara të përfituara prej tij, të depozituara në formën e kërkuar nga ligji.

<sup>66</sup>Vendimi i Kolegjit nr. 11/2019, datë 22.05.2019, për subjektin E. I.

<sup>67</sup>Ndryshimi midis vlerës 36.273 lekë të pretenduar nga subjekti me vlerën 41.109 lekë të rezultuar nga Komisioni, qëndron në faktin se në dallim nga subjekti, Komisioni për udhëtimin e djalit të tij në Itali në datat 31.03.2007-9.04.2007, llogarit më shumë se subjekti 40 euro për 8 ditë qëndrimi, duke konsideruar 5 euro shpenzime ditore për ditë qëndrimi.

vitin 2009, trupi gjykues, pas shqyrtimit të dokumentacionit<sup>68</sup> të ndodhur në dosjen e Komisionit, i rezultoi se mbi truallin me sipërfaqe 1000 m<sup>2</sup> ndodhur në {\*\*\*}, Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka ndërtuar një banesë njëkatëshe me sipërfaqe 71 m<sup>2</sup>, punimet e të cilës, sipas aktit të kolaudimit, kanë përfunduar në datën 15.01.2009.

**28.1.** Trupi gjykues vëren se Komisioni<sup>69</sup> e ka marrë në konsideratë pretendimin e subjektit të rivlerësimit, për periudhën e ndërtimit nga data 12.09.2008-15.01.2009, pasi në ndryshim nga analiza për vitin 2008, përcjellë subjektit me rezultatet e hetimit ku vlera e ndërtimit ishte konsideruar e gjitha në vitin 2008, Komisioni ka reflektuar shpjegimet e subjektit dhe në analizën përfundimtare në vendim e ka shpërndarë vlerën e ndërtimit në vitet 2008 dhe 2009<sup>70</sup>.

**28.2.** Lidhur me pretendimin tjetër të subjektit për reduktimin e kostos së këtij ndërtimi në vlerën 1.660.000 lekë, duke zbritur “Shpenzimet operacionale të EKB-së” në masën 4%, trupi gjykues vlerëson se referuar Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 20.08.2008, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave”, në tabelën nr. 1, në pikën 6 të tij, citohet se: “Në vlerën e kostos mesatare nuk janë përfshirë [...] “Shpenzimet operacionale të EKB-së në masën 4%”, për rrjedhojë pretendimi i subjektit të rivlerësimit për zbritje të mëtejshme të vlerës së këtij ndërtimi është i pabazuar.

**28.3.** Për sa i përket përcaktimit të vlerës së objektit, subjekti i rivlerësimit kërkon të merret në konsideratë dokumenti “akt kolaudimi”, i cili në rubrikën “Të dhëna për zbatimin e kontratës dhe çmimeve të përcaktuara në kontratë”, konkludon se vlera e shpenzimeve sipas situacionit përfundimtar është në vlerën prej 1.660.000 lekësh. Trupi gjykues vëren se procesverbali i kolaudimit, datë 29.01.2009, sipas së cilit vërtetohet dorëzimi i punimeve në datën 15.01.2009 dhe referon në vlerën e një situacioni, është i pamjaftueshëm si dokument provues për përcaktimin e vlerës në referim të kërkesave të Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 13.05.2005, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” kreu III “Dokumentacioni teknik i punimeve të ndërtimit”<sup>71</sup>. Subjekti, me qëllim vërtetimin e vlerës së objektit, duhej të kishte depozituar kontratën e lidhur me sipërmarrësin e punimeve, situacionet pjesore dhe përfundimtare.

**28.4.** Gjithashtu, pretendimet e subjektit lidhur me vlerën e objektit janë të pambështetura me dokumentacion justifikues ligjor edhe në raport me parashikimet e pikës 26 të Udhëzimit<sup>72</sup> të ILDKPKI-së, datë 10.10.2016, “Për mënyrën e deklaramit të pasurive, në pronësi, posedim dhe

---

<sup>68</sup>Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se mbi sipërfaqen e tokës së blerë prej tij është ndërtuar me investime të kryera prej tij një shtëpi me sip. 71 m<sup>2</sup>, e cila në vitin 2012, së bashku me sipërfaqen e tokës i është shitur shtetasit A. P..

<sup>69</sup>Paragrafi 89.3, faqja 36 e vendimit të Komisionit.

<sup>70</sup>Është përlllogaritur vlera ditore e ndërtimit për periudhën 124 ditore, nga të cilat 109 ditë i takojnë vitit 2008 dhe 15 ditë vitit 2009, periudha e ndërtimit sipas pretendimit të subjektit në vitet 2008 e 2009, për periudhën e ndërtimit 12.09.2008-15.01.2009, sipas akt kolaudimit.

<sup>71</sup>Pika 4 e Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005, citon se: “Libri i masave mbahet për çdo objekt e nënobjekt, që ka preventiv dhe është dokument bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve, të kontratës dhe situacioneve. Në të pasqyrohen vëllimet metrike të punimeve, gradualisht me zhvillimin e tyre”.

<sup>72</sup>Për rastet kur subjektet e rivlerësimit dhe/ose personat e lidhur me të, kanë kryer ndërtime, shitesa ose rikonstrukcione të pjesshme ose të plota, për banesa ose çdo ndërtim tjetër, duhet të paraqesin dokumentacionin e plotë ligjor, lejen e ndërtimit, preventivin, situacionin e plotë të shpenzimeve të kryera etj.

*përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016”.*

28.5. Për sa më lart, trupi gjykues e vlerëson të drejtë qëndrimin<sup>73</sup> e Komisionit për referimin në përcaktimin e çmimit të ndërtimit të objektit me sipërfaqe 71 m<sup>2</sup>, sipas Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 20.08.2008, “*Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave*”, duke llogaritur vlerën e objektit në 1.948.169 lekë (71m<sup>2</sup> x 24.439 lekë/m<sup>2</sup> = 1.948.169 lekë).

28.6. Lidhur me pretendimin e subjektit për reduktimin e shpenzimeve të udhëtimit të fëmijëve dhe bashkëshortes në Itali, nga 269.649 lekë në 85.492 lekë, pasi ata kanë qëndruar te vëllezërit e tij, trupi gjykues, referuar dokumentacionit në fashikull, vëren se Komisioni ka reduktuar shpenzimet e qëndrimit, duke marrë në konsideratë faktin se familja ka qëndruar te të afërmit e tij, duke ndryshuar vlerën e shpenzimeve nga 269.649 lekë në 236.390 lekë.

28.7. Trupi gjykues vëren se, pasi subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacion<sup>74</sup> mbështetës për qëndrimin e familjarëve të tij jashtë vendit pas kalimit të barrës së provës, Komisioni i ka reflektuar ato në analizën përfundimtare. Në dallim me analizën e rezultateve të hetimit administrativ, Komisioni, duke llogaritur koston e shpenzimeve për këto udhëtime me 5 euro për ditë qëndrimi, ka reduktuar vlerën e shpenzimeve në 236.390 lekë. Për rrjedhojë, trupi gjykues e gjen të drejtë qëndrimin e Komisionit për llogaritjen e shpenzimeve të subjektit dhe familjes së tij, sipas metodologjisë dhe jurisprudencës tashmë të konsoliduar të Kolegjit në raste të ngjashme.

29. Për vitin 2010, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar të reflektohet në analizën e këtij viti diferenca e rezultuar nga çmimi i shitjes, në raport me blerjen, për automjetin tip “Mercedes-Benz”, me targë {\*\*\*}, blerë në vlerën prej 1.983.820 lekësh.

29.1. Në funksion të shqyrtimit të pretendimit të subjektit, trupi gjykues, pasi verifikoi analizën financiare të Komisionit, për vitin 2008 në zërin pasuri, në krahasim të përshkrimit “*Autoveturë, {\*\*\*}, blerë 500.000 lekë, në vitin 2008 shitur 22.000 euro në vitin 2010*”, ka vendosur vlerën 800.000 lekë. Komisioni në vlerën prej 800.000 lekësh ka përfshirë krahas çmimit të blerjes prej 500.000 lekësh referuar kontratës nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 14.07.2008, edhe vlerën e riparimit prej 300.000 lekësh, referuar procesverbalit të mbajtur pranë ILDKPKI-së në vitin 2016, ku subjekti i pyetur nga inspektorët ka deklaruar se *me sa mbaj mend, servisi i kryer në momentin e blerjes, ka kushtuar rreth 300.000 lekë*. Komisioni për automjetin e shitur<sup>75</sup> në vitin 2010 ka konsideruar si të ardhur vlerën prej 800.000 lekësh dhe jo vlerën prej 22.000 eurosh, referuar kontratës së shitjes.

29.2. Trupi gjykues, në mbështetje të arsyetimit të kryer më lart në këtë vendim (paragrafi 21.9) mbi mënyrën e blerjes dhe shitjes së automjetit tip “Mercedes-Benz”, i vitit të prodhimit 2007, me targë {\*\*\*}, duke i konsideruar çmimet e vendosura në kontratën e blerjes dhe shitjes së këtij

---

<sup>73</sup>Kostoja mesatare e ndërtimit për metër katror në qytetin e Tiranës është 27.439 lekë, ndërtimi me sip. 71 m<sup>2</sup> ka kushtuar 71m<sup>2</sup> x 27.439 lekë/m<sup>2</sup>= 1.948.169 lekë.

<sup>74</sup>Subjekti ka dorëzuar në Komision deklaratën e përpiluar para noterit në Ancona, me vulë apostile, datë 04.09.2019, të vëllait të tij G. H., i cili konfirmon akomodimin e familjes së subjektit të rivlerësimit gjatë qëndrimit në Itali për periudhën 2003-2016. Kontratë qiraje të shtëpisë së banimit të tij në Ancona, Itali.

<sup>75</sup>Në fashikull gjendet kontrata nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 19.07.2010, sipas së cilës ky automjet është shitur në vlerën 22.000 euro.



automjetit, si diproporcionale në raport me faktet dhe provat e administruara, e vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit për të pasqyruar në analizën financiare vetëm pakësimin e pasurisë në vlerën prej 800.000 lekësh, duke konsideruar të barabartë çmimin e blerjes në vitin 2008, me çmimin e shitjes në vitin 2010.

Për sa më lart, pretendimi i subjektit të rivlerësimit për llogaritjen në analizën financiare, ku krahas pakësimit të pasurisë në vlerën prej 1.070.000 lekësh të vendoset në zërin të ardhura edhe vlera 1.983.820 lekë, si diferencë midis çmimit të blerjes dhe çmimit të shitjes së automjetit, është i pabazuar.

30. Lidhur me pretendimin e subjektit për mosllogaritjen si shpenzim të depozitës së tërhequr prej 20.000 eurosh, në “Tirana Bank” në vitin 2010, pasi një pjesë ka shërbyer si kursim për vitin 2011, kur është krijuar pasuria e ndodhur në {\*\*\*}, Tiranë, trupi gjykues konstaton se Komisioni në analizën e tij nuk e ka pasqyruar vlerën prej 20.000 eurosh as si shpenzim dhe as si pjesë të ndryshimit të likuiditetit, pasi kjo depozitë është çelur në datën 09.03.2010 dhe është tërhequr në datën 19.03.2010, pra, veprimet janë kryer brenda vitit kalendarik, për rrjedhojë pretendimi i subjektit nuk qëndron. Në analizën e tij në zërin “*Shpenzime të tjera*” janë pasqyruar shpenzimet e kryera nga tërheqjet e depozitës.
31. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për të përfshirë si të ardhura në analizën financiare të vitit 2012 vlerën e përfituar nga aktiviteti bar-kafe “{\*\*\*}”, në shumën prej 250.000 lekësh, trupi gjykues, nga kontrolli vendimit të Komisionit, konstatoi se në analizën e tij financiare e ka përfshirë shumën 250.000 lekë të përfituar nga ky aktivitet.
32. Subjekti i rivlerësimit kërkon të reduktohen shpenzimet e ushqimit të djalit të tij përkatësisht në janar, shkurt dhe gusht të vitit 2013, në Greqi dhe Kosovë, pasi akomodimi dhe ushqimi janë mbuluar nga shoku i tij në Greqi, si dhe të afërmit e tij në Kosovë. Konkretisht, subjekti kërkon që nga vlera prej 233.203 lekësh e llogaritur nga Komisioni të zbriten shpenzimet e udhëtimit në vlerën prej 41.783 lekësh.

32.1. Në përgjigje të këtij pretendimi, trupi gjykues, pas verifikimit të të dhënave të sistemit *TIMS*, konstatoi se djali i subjektit të rivlerësimit ka udhëtuar në datat 17.01.2013-20.02.2013 për në Greqi, me dalje nga pika kufitare Kakavijë, gjithsej 34 ditë qëndrimi. Në datat 08.08-20.08.2013, ka udhëtuar përsëri me dalje nga pika kufitare Kakavijë, gjithsej 12 ditë qëndrimi. Nga verifikimet e dokumentacionit në fashikull, nuk u gjet ndonjë ftesë apo deklaratë e familjes së shokut të tij V. M., nëpërmjet së cilës të justifikohen shpenzimet e qëndrimit të djalit në shtetin grek. Nuk u gjet dokument justifikues as për qëndrimin e udhëtimit dyditor të datës 08.07-10.07.2013 të djalit në Kosovë, shpenzim për të cilin subjekti pretendon se është përballuar nga të afërmit e tij në Kosovë. Në këto kushte, konkludohet se Komisioni ka llogaritur drejt shpenzimet e udhëtimit për vitin 2013 dhe pretendimi i subjektit nuk qëndron.

33. Për analizën financiare të vitit 2014, subjekti i rivlerësimit kërkon: të rillogariten të ardhurat nga aktiviteti bar-kafe “{\*\*\*}”; të rillogaritet vlera e paguar për shpenzimet e shkollimit të fëmijëve nga 101.654 lekë, në 72.000 lekë; si dhe të reduktohen shpenzimet e udhëtimit të vajzës dhe bashkëshortes së tij në Austri, pasi udhëtimi është realizuar me ftesë të shoqes së vajzës E. T., e cila ka paguar biletat e udhëtimit dhe qëndrimin. Gjithashtu, kërkon të reduktohen kostot e

qëndrimit të djalit në Kosovë, pasi janë përballuar nga të afërmit në Kosovë, si dhe shpenzimet e udhëtimit për këtë vit të reduktohen nga 297.998 lekë, në 163.503 lekë.

**33.1.** Në kontroll të analizës financiare të kryer nga Komisioni për vitin 2014, trupi gjykues, pasi shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit, konstatoi se:

**33.2.** Në lidhje me të ardhurat nga aktiviteti bar-kafe “{\*\*\*}”, u konstatua se këto të ardhura janë llogaritur nga Komisioni në shumën prej 462.830 lekësh, aq sa ka vendosur edhe subjekti në analizën e paraqitur prej tij.

**33.3.** Sa i takon shpenzimeve për shkollimin e fëmijëve nga dokumentacioni në fashikull, u konstatua se në përgjigje të pyetësorit nr. 1, në lidhje me shpenzimet e shkollimit, subjekti ka hartuar një grafik shpenzimesh, referuar të cilit për të dy fëmijët shpenzimet e shkollimit llogariten në shumën 72.000 lekë për vitin 2014. Trupi gjykues, pasi analizoi dokumentacionin<sup>76</sup> vërtetues në lidhje me shkollimin e fëmijëve, vlerëson se Komisioni ka përlllogaritur drejt vlerën për shkollimin e fëmijëve të subjektit të rivlerësimit në vitin 2014 dhe pretendimi i subjektit nuk qëndron.

**33.4.** Në lidhje me pretendimin e subjektit për reduktimin e shpenzimeve të udhëtimit të vajzës dhe bashkëshortes në Austri, trupi gjykues, pas verifikimit të të dhënave të sistemit *TIMS*, konstatoi se udhëtimi është kryer në datat 24.10.2014-28.10.2014, gjithsej 4 ditë qëndrimi për secilin person. Në aktet e administruara gjatë hetimit administrativ në Komisioni nuk gjendet dokumentacion provues për pagesën e udhëtimit nga shoqja e vajzës dhe as deklaratë për përballimin e kostos së qëndrimit, siç pretendon subjekti i rivlerësimit. Edhe për udhëtimin e djalit në Kosovë në datat 19.12-21.12.2014, me dalje nga pika kufitare Morinë, nuk gjendet deklaratë justifikuese për përballimin e shpenzimeve të qëndrimit nga të afërmit e subjektit në Kosovë. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi si të drejtë përlllogaritjen e Komisionit për shpenzimet e udhëtimit gjatë vitit 2014.

**34.** Për vitin 2015, subjekti i rivlerësimit kërkon të reflektohet si e ardhur diferenca pozitive midis çmimit të blerjes prej 7.000<sup>77</sup> eurosh dhe çmimit të shitjes prej 15.000 eurosh të automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targë {\*\*\*}, në kushtet kur janë paguar detyrimet tatimore për këtë të ardhur.

**34.1.** Trupi gjykues vëren se Komisioni në analizën financiare për vitin 2015 ka njohur si të ardhur nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz” vetëm vlerën prej 7.000 eurosh ose 980.770 lekë, sa ka qenë çmimi i blerjes në vitin 2014, ndërsa diferenca e çmimit të shitjes me atë të blerjes prej 8.000 eurosh nuk është njohur për shkak të mospagimit të detyrimit tatimor. Pretendimi i subjektit për të reflektuar në analizën financiare të vitit 2015 diferencën pozitive prej 8.000 eurosh (15.000 euro-7.000 euro) nuk u gjend i drejtë, pasi subjekti i rivlerësimit rezultoi se nuk kishte mundësi

---

<sup>76</sup>Vërtetimet e Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, për të dy fëmijët e subjektit, vërtetimit të Fakultetit të Ekonomisë të Universitetit të Tiranës, për djalin e subjektit, si edhe tarifave vjetore të shkollimit të paraqitura prej tij.

<sup>77</sup>Kontratë shitblerje pasuri e luajtshme nr. {\*\*\*}, datë 05.02.2014, sipas së cilës Kolë e D. Hysenaj kanë blerë nga D. M. automjet të markës “Mercedes-Benz”, me targë {\*\*\*}, me nr. shasie {\*\*\*}, në shumën 7.000 euro, e likuiduar totalisht palës blerëse jashtë zyrës noteriale.

financiare për blerjen e automjetit në vitin 2014, në vlerën prej 7.000 eurosh, duke afektuar në këtë mënyrë dhe ligjshmërinë e të ardhurës së përfituar në vitin 2015 nga shitja e tij.

34.2. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit rezultoi me pamundësi financiare për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targë {\*\*\*}, në vitin 2014 (analizuar më lart në këtë vendim), pra, nuk dispononte burime financiare të ligjshme për blerjen e tij, për pasojë nuk mund të krijonte të ardhura të ligjshme nga shitja e tij në vitin 2015. Prandaj, mospërfshirja e diferencës së çmimit prej 8.000 eurosh ose 1.091.330 lekë, si e ardhur në analizën e vitit 2015, diktohet jo nga fakti se subjekti nuk ka paguar detyrimin tatimor, por sepse nuk kishte burime të ligjshme financiare për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2014.

Nisur nga ky vlerësim do të duhej që në analizën financiare të vitit 2015 të mos përfshihej si e ardhur edhe vlera prej 7.000 eurosh e çmimit të blerjes së automjetit e llogaritur nga Komisioni. Për të mos përkeqësuar pozitën e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerësoi ta konsiderojë këtë vlerë njësoj si Komisioni në analizën financiare, duke mos pranuar pretendimin e subjektit për të njohur si të ardhur krahas shumë prej 7.000 eurosh edhe shumë prej 8.000 eurosh përfituar nga diferenca midis çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së automjetit tip “Mercedes-Benz” me targë {\*\*\*}.

35. Për vitin 2016, subjekti i rivlerësimit kërkon të reflektohet në analizën financiare e ardhura nga shitja e automjetit tip “Peugeot”, pasi është paguar detyrimi tatimor për diferencën pozitive të këtij transaksioni.

35.1. Në përgjigje të këtij shkak ankimi, trupit gjykues, pasi analizoi dokumentacionin e përcjellë nga Komisioni, i rezultoi se me kontratën nr. {\*\*\*}, datë 27.10.2015, subjekti i rivlerësimit ka blerë nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK automjetin tip “Peugeot”, në shumë prej 3.855 eurosh, pagesë e kryer në një nga llogaritë e kësaj shoqërie. Me kontratën nr. {\*\*\*}, datë 30.06.2016, Kolë Hysenaj i ka shitur shtetas K. B. automjetin e sipërpërmendur në shumë prej 5.000 eurosh. Komisioni ka çmuar se, duke qenë se nuk është paguar në kohë tatimi për të ardhurat nga shitja, në analizën përfundimtare të konsiderojë si të ardhur të ligjshme për vitin 2016, jo shumë prej 5.000 eurosh, por çmimin e blerjes së këtij automjeti vlerën prej 3.855 eurosh.

35.2. Në kushtet kur Komisioni ka konkluduar se subjekti ka pasur burime financiare të ligjshme për blerjen e këtij automjeti në datën 27.10.2015, me çmimin 3.855 euro, pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, në mbështetje edhe të interpretimit të mësipërm në këtë vendim mbi detyrimin e pagesës së tatimit për të ardhurën e përfituar nga diferenca e çmimit të shitjes dhe blerjes së automjeteve, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur detyrim për pagesën e këtij detyrimi tatimor. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se në vitin 2016 në analizën financiare si e ardhur nga shitja duhet të konsiderohet edhe diferenca midis çmimit të shitjes prej 5.000 eurosh ose 686.759 lekë dhe atij të blerjes 3.885 euro ose 530.750 lekë konsiderohet i drejtë. Në analizën financiare në Kolegj u reflektua pretendimi i subjektit duke shtuar në zërin të ardhura, diferencën e çmimit prej 156.009 lekësh.

36. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, i cili kërkon reduktimin e shpenzimeve të udhëtimit të vajzës së tij në Belgjikë, pasi është akomoduar te daja i saj, si dhe shpenzimet e subjektit drejt Italisë, pasi ato janë përballuar nga vëllai dhe kunati i tij, trupi gjykues vëren se

shpenzimet e udhëtimit nuk mund të reduktohen nga sa ka llogaritur Komisioni, pasi në aktet e administruara gjatë hetimit administrativ nuk gjendet dokumentacion justifikues për përballimin e tyre nga daja i vajzës së subjektit B. F..

**36.1.** Sa i takon udhëtimit të subjektit të rivlerësimit drejt Italisë në datat 30.07-14.08.2016 me 15 ditë qëndrimi, në fashikull gjenden në formën e kërkuar nga ligji deklaratat e vëllait Gj. H. dhe kunatit të tij T. F., në të cilat është deklaruar se shpenzimet e qëndrimit për subjektin e rivlerësimit dhe familjarëve të tij janë përballuar prej tyre. Trupi gjykues vëren se Komisioni në analizën financiare përfundimtare e ka marrë në konsideratë pretendimin e subjektit, për rrjedhojë vlera e shpenzimeve të udhëtimit për vitin 2016 mbetet ajo e llogaritur nga Komisioni prej 441.081 lekësh.

**37.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se duhet të përfshihet si e ardhur në analizën financiare të vitit 2016 edhe vlera e dietave e përfituar për shkak të ushtrimit të funksionit larg vendbanimit, pasi në këtë periudhë ka qenë i komanduar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë.

**37.1.** Lidhur me këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues çmon se vlerat e dietave<sup>78</sup> nuk mund të konsiderohen si e ardhur, pasi është kompensim për një shpenzim të kryer më parë dhe kanë destinacion mbulimin e shpenzimeve për nevoja ushqimore, transporti apo fjetjeje, të kryera gjatë dhe për shkak të ushtrimit të detyrës.

**37.2.** Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision, si dhe akteve të financës<sup>79</sup>, lidhur me dietat dhe shumat e përfituara gjatë periudhës që ka qenë i komanduar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, rezulton se për këtë periudhë subjekti ka përfituar shumën prej 1.158.500 lekësh.

**37.3.** Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit ka qenë i komanduar për të gjithë vitin 2016, si drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë dhe ka ushtruar funksionin larg vendbanimit të tij për një periudhë relativisht të gjatë kohore, në konsideratë edhe të jurisprudencës së Kolegjit<sup>80</sup>, trupi gjykues vlerëson se përfitimi i vlerës së dietave do të reflektohet në pakësimin e shpenzimeve të jetesës për një person për familjen e subjektit. Analiza financiare e Komisionit, lidhur me llogaritjen e shpenzimeve të jetesës në këtë vit, është korriguar në Kolegj duke llogaritur shpenzimet e jetesës për familjen e subjektit të rivlerësimit për 3 (tre) persona. Në këtë mënyrë, zëri për shpenzimet e jetesës do të ndryshojë nga vlera prej 940.368 lekësh të llogaritura në analizën e Komisionit për familje me katër persona, në vlerën prej 705.276 lekësh të llogaritur për familje me 3 persona.

---

<sup>78</sup>Urdhrat nr. {\*\*\*} dhe {\*\*\*}, datë 04.01.2016, të Prokurorit të Përgjithshëm, për dërgim të drejtuesit dhe komandim prokurori; shkresat nr. {\*\*\*} prot., datë 04.05.2016 dhe nr. {\*\*\*} prot., datë 13.09.2016, të Prokurorisë së Përgjithshme, për komandimin e drejtuesit, z. Kolë Hysenaj, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë; vërtetimi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, datë 27.01.2017, sipas së cilit vlera e dietave për subjektin Kolë Hysenaj, i komanduar si drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, për vitin 2016 ka qenë 1.158.500 lekë.

<sup>79</sup>Urdhër shërbime, fatura tatimore, pagesa bankare, urdhra të drejtuesit të prokurorisë për kryerje pagesash.

<sup>80</sup>Paragrafi 26.9 i vendimit nr. 12, datë 12.05.2021, të Kolegjit që i përket subjektit të rivlerësimit A. M.. Vendimi nr. 18, datë 12.07.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit R. L..

37.4. Në përfundim, duke konsideruar si *cash* të akumuluar shumë 134.900 USD të përfituar nga shitja e truallit në {\*\*\*}, Tiranë, si të ardhur diferencën e çmimit të shitjes dhe blerjes së automjetit në vlerën 156.009 lekë, si edhe duke pakësuar zërin e shpenzimeve të jetesës në vlerën 235.092 lekë, sipas konkluzioneve të mësipërme të trupit gjykues, balanca negative për vitin 2016 nga vlera prej (-) 16.704.238 lekësh, sipas analizës së Komisionit, rezulton në vlerën prej (-) 2.502.075 lekësh.

38. Në përmbledhje të arsytimit të mësipërm, në analizë të situatës faktike dhe ligjore, trupi gjykues konstatoi se balanca negative e përlogaritur nga Komisioni, për shpenzimet dhe investimet e kryera për periudhën 2003-2016, duke pranuar disa nga pretendimet e subjektit të rivlerësimit për zëra të caktuar, reduktohet nga (-) 23.125.856 lekë në (-) 9.241.437 lekë. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, parashikuar nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

39. **Lidhur me kriterin e kontrollit të figurës**, subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se raporti i dytë i përgatitur nga DSIK-ja, i cili ndryshon konstatimin fillestar nga *përshtatshmëri në vijimin e detyrës në papërshtatshmëri për vijimin e detyrës* është plotësisht i pabazë dhe i ngritur mbi fakte që nuk ekzistojnë. Sipas subjektit, të gjitha konstatimet e vendosura në themel të raportit të DSIK-së bazohen tërësisht në pretendime dashakeqëse të dërguara në formë anonime nga një person me qëllimin e vetëm për dëmtimin e imazhit të tij. Grupi i punës së DSIK-së nuk iu është përmbajtur detyrave ligjore që normojnë punën e tyre, pasi nga vlerësimi i të gjitha rrethanave nuk u konstatua asnjë indicie apo rrethanë që të mbështesë konkluzionin e tyre joobjektiv.

39.1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ në Komision, rezulton se DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja<sup>81</sup> vuri në dispozicion të Komisionit raportin për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Kolë N. Hysenaj, me konstatimin për përshtatshmërinë në vazhdimin e detyrës.

39.2. Pas kërkesës së Komisionit për deklasifikimin e raportit dhe përditësimin e të dhënave, DSIK-ja<sup>82</sup> vuri në dispozicion raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Kolë Hysenaj, të deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 27.12.2019, të KDZh-së, nga ku rezulton se për këtë subjekt ka pasur informacion nga institucionet e verifikimit, bazuar në të cilat grupi i punës ndryshoi konstatimin fillestar nga përshtatshmëri në vijimin e detyrës në papërshtatshmëri për vijimin e detyrës.

39.3. Lidhur me sa më lart, trupi gjykues konstaton se Komisioni në vendim nuk ka një konkluzion për kriterin e kontrollit të figurës për subjektin e rivlerësimit, pasi ka arritur në vendimmarrje për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bazuar vetëm në kriterin e pasurisë dhe në

<sup>81</sup> Shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 02.11.2017, e DSIK-së, në dosjen e Komisionit.

<sup>82</sup> Shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 31.12.2019, të DSIK-së, ku përcillet raporti nr. {\*\*\*} prot., datë 19.12.2019, mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Kolë Hysenaj.

vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, sipas pikës 2, të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni ka vlerësuar të mos analizojë gjetjet e tjera në lidhje me kriterin e vlerësimit të figurës dhe atë të aftësive profesionale, për sa kohë që ndonjë përfundim mbi këto kritere nuk mund të ndryshonte vlerësimin përfundimtar bazuar në rivlerësimin e kriterit pasuror. Në kushtet kur mungon vendimmarrja e Komisionit për këtë kriter, bëhet i pamundur nga ana e Kolegjit kontrolli i vendimit për këtë shkak ankimi.

40. **Lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale**, subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji, që bazuar në raportin e grupit të punës mbi aktet dhe praktikën e trajtuara prej tij ndër vite, në konsideratë të konstatimeve të Komisionit (pavarësisht se nuk është shprehur me konstatim përfundimtar në vendim) dhe shpjegimeve të dhëna prej tij gjatë këtij procesi, të vlerësohet “i aftë”, pasi, sipas tij, është provuar se ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, është treguar eficient dhe efektiv në një masë të pranueshme, në përputhje me nenin 44, pika “a” e ligjit nr. 84/2016.

40.1. Nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, rezulton se Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 24.7.2020, i ka dërguar Komisionit raportin për analizën e aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit Kolë Hysenaj. Në raportin e vlerësimit profesional, subjekti është vlerësuar përgjithësisht pozitivisht në drejtim të aftësive profesionale, organizative, etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale, si dhe aftësitë personale dhe angazhimin profesional. Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Kolë Hysenaj dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, ka rezultuar se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Gjithashtu, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit.

40.2. Lidhur me sa më lart, trupi gjykues konstaton se Komisioni nuk ka një konkluzion për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit. Në kushtet kur mungon vendimmarrja e tij për këtë kriter, bëhet i pamundur nga ana e Kolegjit kontrolli i vendimit të Komisionit për këtë shkak ankimi

41. Në përfundim, Kolegji çmon se sa i përket konkluzioneve të tjera të Komisionit, për të cilat subjekti i rivlerësimit nuk ka ngritur shkaqe ankimi, rezultatet e këtyre çështjeve, që janë trajtuar me konkluzionet përkatëse në vendimin e Komisionit, mbeten të pandryshuara, për shkak të moskundërshtimit në ankim nga ana e subjektit të rivlerësimit.
42. Për shkak të konkluzioneve të mësipërme, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, gjendet në kushtet e parashikuara nga neni D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, duke u gjendur në këtë mënyrë një nga rastet e parashikuara për shkarkim dhe, për pasojë, vendimi nr. 368, datë 19.04.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin e tij nga detyra, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

**VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 368, datë 19.04.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Kolë Hysenaj.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 19.12.2023.

**ANËTARE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**ANËTAR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**RELATORE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

## MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Mimoza Tasi, në cilësinë e anëtares, jam dakord me vendimin nr. 54, datë 19.12.2023, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim Kolegji), që i përket subjektit të rivlerësimit Kolë Hysenaj, me të cilin është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. 368, datë 19.04.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), por kam mendim paralel me shumicën e trupit gjykues, për sa i përket qëndrimit të mbajtur dhe konkluzionit të arritur, lidhur me moskonsiderimin në analizën financiare të kursimeve në gjendje *cash* të subjektit të rivlerësimit për periudhën 2003 – 2015, të cilat kanë shërbyer për krijimin e pasurisë “tokë arë”, me sipërfaqe 2000 m<sup>2</sup>, të ndodhur në {\*\*\*}, Tiranë.
2. Trupi gjykues i Kolegjit, në paragrafin 13.5 të vendimit, lidhur me deklarimin e *cash*-it, është shprehur: *“Në analizë të fakteve të mësipërme, trupi gjykues, duke analizuar në harmoni provat dhe aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, ka marrë në konsideratë vetëm deklarimin në deklaratën e interesave periodike të vitit 2016, për përdorimin e të ardhurave nga shitja e pasurisë në {\*\*\*}. Pretendimet e tjera të subjektit të rivlerësimit, lidhur me gjendjen e *cash*-it, të padeklaruar në asnjë prej deklaratave periodike të viteve 2003-2015, posedimin në banesë të të ardhurave të përfituara, sipas tij, nga kursimet vjetore apo nga shitjet e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme ose përdorimin e tyre, i vlerëson të pabazuara”*.
3. Komisioni në vendim, për deklarimin e *cash*-it, ndër të tjera, është shprehur se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime si gjendje likuiditeti *cash* ose në bankë në asnjë nga deklaratat periodike vjetore (në vijim DPV), përpara vitit 2011 kur është blerë pasuria, duke konkluduar se subjekti ka pamundësi për krijimin e saj, pasi ka mungesë burimesh të ligjshme financiare në vlerën prej (-) 5.105.654 lekësh.
4. Subjekti i rivlerësimit, për pasurinë “tokë arë”, me sipërfaqe 2000 m<sup>2</sup>, të ndodhur në {\*\*\*}, Tiranë, pretendon se nëse merren në konsideratë kursimet që ka krijuar gjatë viteve 2003 –2010, të siguruara nga pagat, aktiviteti bar-kafe dhe diferenca e shitblerjeve të pasurive, ai do të rezultonte me një balancë pozitive në vlerën prej 8.023.170 lekë.
5. Në lidhje me deklarimet e subjektit të rivlerësimit, në deklaratën *vetting* për “kursimet nga pagat gjatë viteve”, të përdorur si një nga burimet për krijimin e pasurisë së paluajtshme “tokë arë”, me sipërfaqe 2000 m<sup>2</sup>, në vitin 2011, me kontratë blerjeje nr. {\*\*\*}, datë 16.9.2011, në {\*\*\*}, Tiranë, në vlerën prej 11.160.000 lekësh, nga analizimi i DPV-ve rezulton se:
  - 5.1 Në DPV-të për vitet 2003 – 2011, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime në gjendje *cash*. Këtë konstatim, subjekti e ka pranuar vetë gjatë hetimit administrativ në Komision, duke e konsideruar një pakujdesi.
  - 5.2 Në DPV-në e vitit 2009, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar: *“Lekë shqiptare, konvertuar në euro, së bashku me të ardhurat e viteve të mëparshme dhe ndodhen në llogari bankare [...]. Vlera: 1.800.000 lekë”*.
  - 5.3 Në DPV-në e vitit 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se *për blerjen e kësaj toke, përveç të ardhurave të deklaruara në vitet e shkuara [...]*, po në këtë vit, bashkëshortja e subjektit ka



deklaruar *lekë shqiptare konvertuar në euro. Për këtë shumë janë 12.857 euro, të tjera euro janë të viteve të mëparshme, të deklaruar më parë [...].*

5.4 Në deklarimin e dhënë pranë ILDKPKI-së në qershor të vitit 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursimet nga paga si një nga burimet për krijimin e pasurisë.

6. Nga analiza financiare, që Komisioni ka kryer për periudhën 2003 – 2016, konstatohet lehtësisht se subjekti i rivlerësimit për periudhën 2003 – 2011 rezulton me balanca pozitive në vitet 2003 – 2007 dhe në vitin 2009. Në vlerësimin tim, këto balanca pozitive, që në total shkojnë në vlerën prej 3.803.315 lekësh, edhe pse nuk pranohen nga Komisioni dhe nga shumica e trupit gjykues, janë kursimet në *cash* që subjekti i rivlerësimit i pretendon në ankim. Këto kursime, edhe pse nuk janë deklaruar të shprehura në mënyrë eksplicite në DPV-të për periudhën e rivlerësimit, analiza financiare i evidenton qartë që mund të krijoheshin nga të ardhura të ligjshme.
7. Sa i përket arsytimit të pjesës tjetër të trupit gjykues, referuar qëndrimin në jurisprudencën e Kolegjit për gjendjen *cash*<sup>83</sup> dhe deklarimin në DPV-të si mënyrë e vetme e të provuarit të ekzistencës së tij, konsideruar si prova në procesin e rivlerësimit<sup>84</sup>, rishpreh edhe njëherë qëndrimin tim<sup>85</sup> të ndryshëm nga shumica se jodomosdoshmërisht mosdeklarimi i *cash*-it provon mosekzistencën e tij. Pavarësisht mosdeklarimit të tyre në mënyrë të shprehur, provohet se ato kanë ekzistuar dhe janë të ardhura të krijuara me burime të ligjshme e, në këto rrethana, duhet të ishin marrë parasysh nga shumica në analizën financiare të subjektit.
8. Vlerësoj se kompleksitetit që shoqëron procesin e rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në Aneksin e Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, duke përfshirë në analizë rrethana e fakte të shumta që lidhen me të, përfshirë edhe të provuarit e ekzistencës së *cash*-it, nuk duhet t'i bëhet një interpretim *rixhid* dhe analizë mekanike dhe e ngurtë e deklaratave vjetore të pasurisë, të cilat **mund të përbëjnë** vetëm një provë në këtë proces pa asnjë vlerë të shtuar në krahasim me provat e tjera të administruara.
9. Duke i qëndruar mendimit që vlerësimi dhe interpretimi për pranimin e ekzistencës së likuiditeteve *cash* duhet bërë rast pas rasti edhe për mundësinë e krijimit të një *cash*-i të ligjshëm, por të padeklaruar nga shkaqe që kanë ose jo një peshë të caktuar në analizën financiare, si dhe në historikun e deklarimit të pasurive dhe interesave financiare të subjekteve të rivlerësimit, në rastin e subjektit Kolë Hysenaj rezulton se:

9.1 Nga verifikimi i DPV-ve për vitet 2003 – 2011 rezulton që subjekti të mos ketë deklaruar kursime në gjendje *cash* në banesë, por ka deklaruar vetëm të ardhurat e ligjshme të tij dhe të personit të lidhur (bashkëshortes).

---

<sup>83</sup>Vendim nr. 8/2019 (JR), datë 16.04.2019, paragrafi 43; vendim nr. 7/2019 (JR), datë 05.04.2019, paragrafi 32.5; vendim nr. 29/2019 (JR), datë 08.11.2019, paragrafi 31; vendim nr. 1/2020 (JR), datë 15.01.2020, paragrafi 50; vendim nr. 11/2019(JR), paragrafi 27; vendim nr.27/2020(JR), paragrafi 19.4v.

<sup>84</sup>Neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 parashikon se: “Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë të paraqitura më parë te ILDKPKI-ja **mund të përdoren** si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelimit”.

<sup>85</sup>Vendim nr. 41/2022 (JR), datë 31.10.2022.

[https://kpa.al/wpcontent/uploads/2023/02/Vendim\\_Eda\\_Kaja\\_perfshire\\_pakicen\\_anonimizuar.pdf](https://kpa.al/wpcontent/uploads/2023/02/Vendim_Eda_Kaja_perfshire_pakicen_anonimizuar.pdf)

9.2 Në këtë periudhë, edhe pse nuk ka deklarime për gjendjen *cash* (shtesa ose pakësime), sipas parashikimit në nenin 4<sup>86</sup> të ligjit nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, konstatohet se në disa vite, si për shembull në DPV-të e viteve 2009, 2011 dhe në shpjegimet e dhëna pranë ILDKPKI-së në vitin 2016, subjekti i rivlerësimit referon në “*të ardhurat e viteve të shkuara/të mëparshme*”, duke dhënë një indicie për mënyrën se ai e ka nënkuptuar në këtë mënyrë “*tepricën*” e kursimeve, si diferencë e thjeshtë e të ardhurave të ligjshme të deklaruara periodikisht me shpenzimet, sipas standardeve të përlllogaritjes së ILDKPKI-së.

9.3 Nga verifikimi i deklaratës *vetting*, lidhur me pasurinë “tokë arë“, me sip. 2000 m<sup>2</sup>, në {\*\*\*}, Tiranë, rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë bërë deklarim të saktë të burimeve të krijimit të kësaj pasurie, duke u shprehur qartë se një nga burimet e krijimit të saj janë [...] *kursime nga paga gjatë viteve*;

9.4 Sjellja e subjektit gjatë gjithë periudhës së deklarimit periodik rezulton që të jetë e njëjtë, e pandryshuar që, në vlerësimin tim, përbën një qëndrim konsistent dhe të besueshëm se ajo ka qenë mënyra se si subjekti i rivlerësimit ka kuptuar plotësimin e deklaratave periodike të deklarimit të pasurisë dhe interesave financiare në vite.

9.5 Shpjegimet e dhëna pranë ILDKPKI-së me procesverbal, në qershor të vitit 2016, ku për herë të parë nga organi kontrollues i kërkohet subjektit që të japë informacion të plotë se sa kanë qenë kursimet në të gjitha vitet e deklarimit, çmoj se mund të kenë vlerën e provës, ashtu si DPV-të, për sa kohë janë dhënë përpara plotësimin të deklaratës *vetting* nga subjekti i rivlerësimit dhe përpara fillimit të hetimit administrativ të procesit të rivlerësimit.

10. Për sa më lart analizuar, duke qenë se subjekti ka pranuar vetë mosdeklarimin e gjendjes *cash* në DPV-të ndër vite, duke konsideruar se edhe pse në kushtet e mosdeklarimit rezultojnë disa indicie që shprehin mundësinë për krijimin e *cash*-it, nëpërmjet shprehjeve të *ardhurat e viteve të shkuara/të mëparshme*, si dhe duke provuar mundësinë e krijimit të tepricave/balancave pozitive të paktën për vitet 2003-2007 dhe vitin 2009, vlerësoj se shumica e trupit gjykues, në një qëndrim garantist, duhej që të kishin konsideruar mundësinë e krijimit të kursimit në gjendje *cash* në vlerën prej 3.803.315 lekësh, e përlllogaritur në Kolegj dhe jo në vlerën prej 8.023.170 lekësh, që pretendon subjekti i rivlerësimit për vitet 2003 – 2010.
11. Konsiderimi i kursimit në gjendjen *cash* në vlerën prej 3.803.315 lekësh nga shumica e trupit gjykues do të ulte pamundësinë e konstatuar nga Komisioni për krijimin e pasurisë “tokë arë”, në {\*\*\*}, Tiranë, pasi ka mungesë burimesh të ligjshme financiare nga vlera prej (-) 5.105.654 lekësh për blerjen e kësaj pasurie, në vlerën prej (-) 1.302.339 lekësh.
12. Për sa më lart, analiza financiare e subjektit të rivlerësimit, sipas konkluzionit të shumicës së trupit gjykues në paragrafin 38 të vendimit, pas konsiderimit të një pjese të pretendimeve të

---

<sup>86</sup>Neni 4: “Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë [...] gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: [...] (d) vlerën e likuiditeteve, **gjendje në cash**, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj [...].”

subjektit në vlerën prej (-) 9.241.437 lekësh, nëse do të ishte gjetur e besueshme mundësia e kursimit të *cash*-it prej 3.803.315 lekësh, do të ulej në vlerën prej (-) 5.438.122 lekësh, vlerë e cila sërish nuk do të mund ta nxirrte subjektin e rivlerësimit jashtë kualifikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, për shkak të mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive.

**GJYQTARE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*